



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:140305  
Datë: 29.06.2023  
Numri i dokumentit: 04437671

**APS.nr.19/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Afatërdita Bytyçi– anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve L.G. për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 dhe par. 3, pika 4 në lidhje me paragrafatin 1 të KPRK-së, Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 372/2 lidhur me par 1 të KPRK-së, Vjedhja e identitetit nga neni 336/1 të KPRK-së, i akuzuari K.SH për shkak të veprës penale të Ndihma nga neni 33 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së në ndërlidhje me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, të akuzuarit L.G. dhe K.SH në bashkëkryerje për shkak të veprës penale Shpëlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesat, mbrojtësve të të akuzuarve, L.G. av. Tahir Rrecaj e av. Selman Bogiqi, K.SH av. Florent Latifaj, dhe ankesat e palëve të treta, dhe atë: NTP X-T– B.T av. Naim Spahiu, H-B SH.P.K. e NTPSH H - N.H av. Sylë Hoxha, P.F SHPK-G.D, M.B.G– J.B av. Florim Vërtopi, „G.K SHPK”-G.G av. Nazmi Mustafati, R.H - R.M av. Ethem Rogova, K SHPK – A.Z av. Eset Berisha, F.P CM – L.M.B , KF G.LL – B.B, B.Sh, G SHPK – H.Sh av. Tomë Gashi, A.M.S – S.E av. Kushtrim Bytyqi, I.TH.M SHPK av. Shpresa Berisha-Rexhepi, NTP N. – M.N, E. SHPK – I.P av. Leutrim Sylja, F.B – F E SHPK av. Blerim Mazreku, N.SH SH.P.K – M.P, dhe D.C SH.P.K-F.G, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/21, i datës 07.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.05.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN si të pabazuara** ankesa e përbashkët e mbrojtësve e të akuzuarit, L.G.-av. Tahir Rrecaj dhe Selman Bogiqi, e të akuzuarit K.SH- av. Florent Latifaj, si dhe e palëve të treta, dhe atë: NTPT X-T - B.T av. Naim Spahiu, H-B SH.P.K. e NTPSH H - N.H av. Sylë Hoxha, P.F

SHPK-G.D, M.B.G– J.B av. Florim Vërtopi, G.K SHPK-G.G av. Nazmi Mustafati, R.H - R.M av. Ethem Rogova, K SHPK – A.Z av. Eset Berisha, F.P CM – L.M.B , KF G.LL – B.B, B.Sh, G SHPK – H.Sh av. Tomë Gashi, A.M.S – S.E av. Kushtrim Bytyqi, I.TH.M SHPK av. Shpresa Berisha-Rexhepi, NTP N. – M.N, E. SHPK – I.P av. Leutrim Syla, F.B - F E SHPK av. Blerim Mazreku, N.SH SH.P.K - M.P, dhe D.C SH.P.K, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/21, i datës 07.12.2022, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.43/21, të datës 07.12.2022, të akuzuarin L.G. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 dhe par. 3, pika 4 në lidhje me paragrafatin 1 të KPRK-së, Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 372/2 lidhur me par 1 të KPRK-së, Vjedhja e identitetit nga neni 336/1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarin K.SH për shkak të veprës penale të Ndhimës nga neni 33 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së në ndërlidhje me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, të akuzuarit L.G. dhe K.SH, në bashkëkryerje për shkak të veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që:

Të pandehurit L.G. i ka shqiptuar:

- Për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 dhe par. 3 pika 4 në lidhje me par. 1 të KPRK-së, dënim me gjobe prej 3000 euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 vite e 6 muaj.
- Për veprën penale Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 327 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK – së, dënim me gjobe prej 500 euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje 2 vite.
- Për veprën penale Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 par. 1 të KPRK-së dënim burgimi 6 muaj.
- Për veprën penale të kryer në bashkëkryerje Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 i Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dënim me gjobe prej 5000 euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 viteve.

Të pandehurin K.SH i ka shqiptuar:

- Për veprën penale të Ndhimës nga neni 33 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së në ndërlidhje me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, dënim me gjobe prej 3000 euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 vite.

- Për veprën penale të kryer në bashkëkryerje Shpërlaja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 i Ligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dënim me gjobe prej 30.000 euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 viteve.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 nënpar.2.2 ndaj te pandehurve i ka shqiptuar dënim unik me burgim dhe gjobë:

1. Të pandehurit L.G. i ka shqiptuar **dënim unik me gjobë në shumën prej 8500 euro** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat n prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe **dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11 vite burgim.**

Konform nenit 59 par.1 dhe 2 nënpar.2.3 dhe nenit 63 par.4 të pandehurit L.G. i ka shqiptuar **dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për periudhën 6 vjeçare**, nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, koha e kaluar në vuajtje të dënimit nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues.

2. Të pandehurit K.SH i ka shqiptuar **dënim unik me gjobë në shumën prej 33.000 euro** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afatat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe **dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 vite burgim.**

Konform nenit 43 par.3 të KPRK-së nëse të pandehuri L.G dhe K.SH nuk paguajnë gjobën e shqiptuar, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim me burgim, 20 euro gjobë do ti llogaritet me një (1) ditë burgim.

Konform nenit 79 par.1 të KPK-së të pandehurit L.G i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.10.2020, ndërsa të pandehurit K.SH nga data 26.10.2020

Bazuar në dispozitën e nenit 367 par.2 të KPPRK-së të pandehurve L.G dhe K.SH i është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmëri e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Bazuar në nenin 92 të KPRK-së dhe neneve 276, 278, të KPPRK – së është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale e cila gjendet tek palët e treta të poshtëshënuara:

Konfiskohet dobia pasurore e fituar nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë konkretisht mjetet monetare të ngrira sipas urdhëresës së gjykatës si mjete të cilat kanë rrjedhë nga aktiviteti kriminal i të pandehurve dhe të njëjtat transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

Nr.	Emri i Bankës	Emri i subjektit/Pronarit	Nr. i llogarisë	Shuma e ngrirë
-----	---------------	---------------------------	-----------------	----------------

1.	PCB	N P – B.R	-----	27,289.00
2.	PCB	A.M.S – S.E	-----	30,000.00
3.	PCB	G SHPK – H.Sh	-----	50,000.00
4.	PCB	M.B.G– J.B	-----	20,100.00
5.	RBKO	A.T – L.G	-----	3,828.00
6.	RBKO	H-B SH.P.K. – N.H	-----	51,452.50
7.	RBKO	NTPSH H - N.H	-----	50,520.00
8.	RBKO	U.T SHPK – N.N	-----	8,678.93
9.	BPB	NTPT X-T– B.T	-----	26,068.26
10.	BKT	G SHPK – Sh.Xh	-----	10,000.00
11.	RBKO	R.H – R.M	-----	8,000.00
12.	PCB	F.B – F E SHPK	-----	30,000.00
13.	RBKO	K.B - D.K BI	-----	15,000.00
14.	RBKO	K.B - D.K BI	-----	42,000.00
15.	BKT	B.S.H	-----	11,017.15
16.	NLB	KF G.LL – B.B	-----	3,098.20

17.	RBKO	K SHPK – A.Z	-----	1,710.00
18.	PCB	A.M.S SHPK – S.E	-----	6,500.05
19.	NLB	NT HY – N.M	-----	2,797.50
20.	NLB	EP SH.P.K – F.D	-----	2,250.00
21.	TEB	E. SHPK – I.P	-----	10,765.63

**411,075.22**

Gjithashtu ka konfiskuar dobinë pasurore të fituar nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë konkretisht mjetet monetare të arkëtuara nga bankat komerciale (të cilat janë listuar si më poshtë), mjete këto që janë ndaluar nga bankat për pagesën / mbylljen e kredisë apo overdraftit (mbitërheqjes), mjete të cilat rrjedhim nga aktiviteti kriminal i të pandehurve dhe janë përdorur për të paguar obligime bankare dhe të njëjtat ri- kthehen / transferohen në llogarinë e mirëbesimit që është hapur në emër të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me numër të llogarisë 1000400070008716 me status ligjor llogari (e dedikuar) në kuadër të sistemit të LLVTH, e të cilat do ti transferohen Buxhetit të Republikës së Kosovës, dhe ato bankat si në vijim:

Nr.	Emri i Bankës	Emri i subjektit/Pronarit	Nr. i llogarisë	Shuma
1.	Ziraat Bank	G.K SHPK – B.G.	-----	28,500.00
2.	RBKO	G.K SHPK – B.G.	-----	14,792.00
3.	PCB	N P - B.R	-----	12,711.00
4.	Ziraat Bank	I.M SHPK – M.LL	-----	3,229.00
5.	BKT	U.T SHPK - N.Z	-----	184,816.07

6.	BPB	F.P C M – L.M.B	-----	13,932.34
7.	PCB	I.G SHPK – V.G.	-----	7,446.85
8.	PCB	P.F SHPK -	-----	6,722.55
9.	BPB	D-C SHPK – F.G	-----	50,000.00
10.	BKT	SH.RE BI	-----	10,000.00
11.	RBKO	N.SH SH.P.K – M.P	-----	5,000.81
12.	BKT	E-A SHPK – K.RE	-----	144,500.00
13.	TEB	NTP D-CO– I.G	-----	8,919.18
14.	PCB	NTP N. – M.N	-----	26,000.00
15.	PCB	SU NTSH – Mehmet SU	-----	10,000.00
16.	PCB	D-KN DPT - I.M B.I	-----	2,330.30
17.	TEB	E. SHPK – I.P	-----	2,331.22
18.	RBKO	K SHPK – A.Z	-----	99.86
19.	RBKO	A.T – L.G	-----	1,176.00
				<b>532,507.18</b>

Bazuar në nenin 92 të KPRK-së dhe neneve 276 të KPPRK – së gjykata ka konfiskuar:

- Automjetin e tipit “Audi A4” me targa 01-000-00, me numër të shasisë XXXXXXXXXXXX, në emër të F.M– G bashkëshorte e të pandehurit L.G me librezë të qarkullimit numër VRD ---.
- Automjetin e tipit “A5” Sport Back, ngjyrë e bardhë, me numër të shasisë XXXX, me targa 04-000-00, e regjistruar me datë 10.10.2020 në emër të subjektit juridik G-KO sh.p.k. me seli në fshatin Shirokë, Komuna Suharekë, me pronar G-GA.
- Automjetin e tipit “A5” Sport Back, ngjyrë e zezë, me numër të shasisë XXXXXXXXXXXX, me targa 04-----, e regjistruar me datë 13.10.2020, në emër të subjektit juridik G-KO sh.p.k, me seli në fshatin Shirokë, Komuna Suharekë, me pronar G-GA.
- Automjetin e tipit Taur, ngjyrë e bardhë, me targa -----HP, me numër të shasisë XXXXX, i regjistruar në emër të B.Sh me numër personal 10555.

Kurse, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit Agjencinë për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, e ka obliguar që t`i marr nën administrim dhe menaxhim veturat e konfiskuara dhe e njëjta ka të drejtë që sendet e lartcekura t`i shesë dhe paratë nga shitja t`i administroi në përputhje me ligjin mbi Agjencinë.

Ka obliguar të pandehurit L.G dhe K.SH që të dëmtuarës Ministria Financave Punës dhe Transfereve – Thesari i Kosovës, në mënyrë solidare t`ia kompensojnë dëmin në lartësi prej 1,134,413.50 euro, ashtu që së bashku me konfiskimit në mënyrë të përhershme të mjeteve monetare nga gjykata e të cilat janë gjetur tek palët e treta, të përmbushet vlera prej 2,077,995.90 euro e dëmit të shkaktuar, të gjitha këto në afatat prej 90 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ka obliguar të pandehurit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë secili veç e veç shumën nga 300 €, ndërkaq në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit t`i paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 50 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afat n ligjor ankesë kanë ushtruar:**

Mbrojtësi i të akuzuarit L.G av. Tahir Rrecaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën parag. 1.12 lidhur me nenin 370, parag. 6 dhe 7 dhe par. 2 lidhur me nenin 3 të dhe nenin 18 të KPRK-së, shkeljes së ligjit penal, nga Neni 385 parag. 1, nën parag. 1 dhe 4 të KPPRK-së, Vërtetimit të gabueshëm dhe jo ti plotë të gjendjes faktike nga neni 386, parag. 2 dhe 3 të KPPRK-së, si dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal (për të gjitha veprat penale për të cilat është shpall fajtor, pika 1 deri 3 e aktakuzës, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, dhe në pajtim me nenin 403 të KPPRK-së ta ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar, ashtu që të pandehurin z. L.G, ne bazë të nenit 364. parag. 1, nën parag. 3 të KPPRK-së, ta liroj nga akuza

për veprën penale: Shpëlarja e parave nga neni 302 KPRK-së, lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 i Ligjit nr. 05/1,-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sepse nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se ai e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, apo që në pajtim me nenin 402 parag. 1, nën parag. 1.1 dhe 1.2 të KPRK-së, ta anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim (për veprën penale nga pika III e aktgjykimit (pika IV e aktakuzës). Ta ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar sa i përket vendimit mbi sanksionin penal për të gjitha veprat penale për të cilat është shpall fajtor (pika 1 deri 3 e aktakuzës), ashtu që ndaj z. Gruda të shqiptoj dënim me të butë me burgim, për secilën veprë penale veç e veç dhe dënim unik.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.SH av. Florent Latifaj, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të vendimit lidhur me dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta miratoj ankesën, ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë, dhe të pandehurin ta liroj nga akuza ose çështjen ta kthejnë rigjykim.

### **Palët e treta, dhe atë:**

P-F SHPK, G.D, për shkak të konfiskimit të dobisë pasurore nga vepra penale e cila pasuri gjendet tek pala e tretë, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe të ligjshme kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departament Speciali, nr. i lëndës 2020:140305, të datës 31.01.2023 me të cilin aktgjykim nga subjekti ekonomik P-FSHPK me seli në fsh. Sojevë, komuna e Ferizajt nga xhirollogaria e subjektit të konfiskohen 6,72225 euro, të cilat mjete sipas aktgjykimit në fjalë gjenden në posedim dhe janë paguar nga mjetet e fituara nga vepra penale.

H-B SH.P.K. dhe NTPSH H- me pronarë N-H, av. Sylë Hoxha, për të gjitha bazave ligjore të parapara për ankimim, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi dhe atë vetëm sa i përket pjesës së konfiskimit të dobisë pasurore të fituar nga vepra penale që gjenden në posedim të palës së tretë, të ngrira sipas urdhëresës së gjykatës për palën e tretë "H-B" SH.P.K. në shumë prej 51,452.50€ dhe NTPSH H, në shumë prej 50,520.00€ euro dhe të njëjtat ti kthehen "H-B" SH.P.K dhe NTPSH H me pronarë N.H.

N.T.P X-T, me pronar B.T, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën e palës së tretë me interes në këtë çështje kompanisë B.T B.I, me emër tregtar X-T me seli në Rahovec ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special me numër PS. 43/21 të datës 07.12.2022, të atakuar ta ndryshoj përkitazi me konfiskimin e dobisë pasurore e fituar nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë konkretisht mjeteve monetare të ngrira sipas urdhëresës së gjykatës dhe transferimin e këtyre mjeteve në Buxhetin e Republikës së Kosovës këtu për palën e tretë N.T.P X-T në bankën Banka për Biznes (BPB) me nr. të xhirollogarisë -----, me pronar B.T, në vlerën totale prej 26,068,26 euro.



D-CO SH.P.K, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, ta miratojë të bazuar ankesën e ushtruar nga subjekti ekonomik ndërmarrja "D-CO" SH.P.K, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special me numër PS.43/21, i dt. 07.12.2022, ashtu që lirohet llogaria bankare e ndërmarrjes C-COSH.P.K pran BPB bankë me numër të llogarisë -----, anulohet vendimi për konfiskimin e pasurisë që është gjetur tek palët e treta ose që aktgjykimi i sulmuar në këtë pjesë të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje.

NTSH Shef, SH.P.K, av. Prenk Pepaj, për shkak të shkeljeve esenciale dispozitave të KPPK-ës, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës material, si dhe vendimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore, me propozim që aprovet ankesa e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të datës 07.12.2021, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore PS.nr.43/21, i datës 07.12.2022, ashtu që NTSH Shef, SH.P.K lirohet nga akuza sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore në shumë prej 5.000.81€, në mungesë të provave, ose lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë dhe ndërpritet procedura e konfiskimit të dobisë pasurore në shumë prej 5.000.81€, ndaj NTSH” Shef” sh.p.k, me seli Gjakove në shumë prej 5.000,81€, deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit.

F.B dhe F E SH.P.K., av. Blerim Mazreku, për të gjitha bazat ankimore, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi dhe atë vetëm sa i përket pjesës së konfiskimit të dobisë pasurore të fituar nga vepra penale që gjenden në posedim të palës së tretë, të ngrira sipas urdhërësës së gjykatës për palën e tretë F.B - F E SH.P.K., në shumë prej 30.000 euro dhe të njëjtat ti kthehen F E SH.P.K.

E. SHPK – I.P av. Leutrim Sylja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë gjendjes faktike, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit, me propozim që gjykata të ketë parasysh rrethanat procedurale dhe materiale në rastit dhe të vendosë në lidhje me rastin duke pasur parasysh se pala e treta është e dëmtuar në aspektin e imazhit, në aspektin financiar pasi që pagesat e pranuar janë kundërvlerë e materialit të shitur elektrik i cili as nuk është në stok më, e edhe paratë për shitjen e tij po pretendohen të konfiskohen.

NTP N. – M.N, për shkak të vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare shumes prej 26,000.00€, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë- Departamenti Special të aprovoj ankesën time, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë PS.nr.43/21 të datës 07.12.2022 sa i përket vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare në shumën 26,000.00€ duke i liruar ato mjete.

A.M.S – S.E av. Kushtrim Bytyqi, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe për shkeljes të ligjit penal,

me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar me numër të lëndës: 2020: 140305 - PS.nr. 43/21, dt. 31.01.2023, të ndryshohet, ashtu që palës së tretë MS SH.P.K. i hiqet masa e konfiskimit nga mjetet monetare prej 30,000.00 Euro të ngrira në PCB.

I.TH.M SHPK av. Shpresa Berisha-Rexhepi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, ashtu që urdhri ndalues afatatgjatë për ngrirjen e xhirrollogarisë bankare nr. ---- në Zirat Bank të hiqet, ose të anulohet dhe lënda të kthehet në shkallën e parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

G SHPK – H.Shav. Tomë Gashi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale: 384 al.2 pika 2, pika 2.1 dhe 2.2 të KPPRK-se, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale: 384 al. 1 pika 1.12 të KPPRK-se, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 383 al.1.3, si dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPPRK-se, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën, dhe të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PS.43/21 dt.31.01.2023 dhe të anuloj vendimin për konfiskim të mjeteve financiare të palës së tretë respektivisht subjektit "G SH.P.K" me pronar H.Sh nga Gjilani, në shumën prej 50.000 euro (pesëdhjetë mijë euro) të deponuara në llogarinë ----- në PCB — ProCreditBank, dhe të urdhëroj de bllokimin e kësaj llogarie bankare.

B.Sh, për shkak të vendimit mbi konfiskimin e Automjetit tip Taur, me propozim që Gjykata e Apelit, në Prishtinë- departamenti Special të aprovoj ankesën time, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë PS.nr.43/21 të datës 07.12.2022 sa i përket vendimit mbi konfiskimin duke e liruar automjetin.

KF G.LL – B.B për shkak të vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare shumës prej 3,098.20€, me propozim që Gjykata e Apelit, në Prishtinë- departamenti Special të aprovoj ankesën time, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë PS.nr.43/21 të datës 07.12.2022 sa i përket vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare në shumën 3,098.20€ duke i liruar ato mjete.

F.P C M – L.M.B për shkak të vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare shumës prej 13.932.346€, me propozim që Gjykata e Apelit, në Prishtinë- departamenti Special të aprovoj ankesën time, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë PS.nr.43/21 të datës 07.12.2022 sa i përket vendimit mbi konfiskimin e mjeteve financiare në shumën 13,932.34€ duke i liruar ato mjete.

K SHPK – A.Z, av. Eset Berisha, pa precizuar bazat ankimore, me propozim që të anulohet pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Special, për konfiskimin e mjeteve të cilat gjendet tek palët e treta, pika 17. K sh.p.k. në shumë prej 1,710 euro dhe mjetet të cilat janë arkëtuar nga bankat komerciale pika K sh.p.k. RBKO në vlerë prej 99.86 euro, ashtu që të lirohen llogaritë bankare të kompanisë K sh.p.k me nr. të xhirrollogarisë: ----- pranë Raiffessen Bank në Prishtinë, me pronar A.Z.

R.H - R.M av. Ethem Rogova, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale - neni 383 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 384 par. 1 pika 1.12 të KPP, shkeljes së ligjit penal - neni 383 par. 1, pika 1.2 lidhur me nenin 385 par. 1, pika 1.4 të KPP, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike - neni 383 par. 1 pika 1.3 lidhur me nenin 386 të KPP si dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale neni 383, par. 1.4, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e ankimuar të ndryshojë ashtu që të debllokojë llogarinë rrjedhëse R-H SH.A. si edhe të detyrojë shumën prej 8.000,00 (tetë mijë) euro të kthejë në llogarinë rrjedhëse të palës së tretë "R-H " SH.A. ose në këtë pjesë të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe kthejë lenden në rigjykim dhe vendosje.

G.K SHPK-G.G av. Nazmi Mustafati, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të vendimit për sanksion penal, lidhur me ngrirjen e aseteve dhe konfiskimin e pasurisë të palës së tretë subjektit G.K SHPK, me propozim që gjykata e apelit ta aprovon ankesën si të bazuar sa i përket palës së tretë subjektit G.K SHPK dhe anulon aktgjykimin e ankimuar së Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special, dhe kthimin e lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për rigjykim dhe vendosje, ose të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës themelore, e tërë kjo sa i përket palës së tretë subjektit " G.K SHPK". Në kuptim të përcaktimeve të nenit 390.1 të KPP, kërkojmë që pala e pakënaqur pala e tretë G-KOMSHPK dhe përfaqësuesi i saj avokati Nazmi Mustafati, të informohen dhe të ftohen në seancën e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit. Në kuptim të dispozitave të nenit 392 paragrafit 2 i KPP, sugjerojmë i akuzuari dhe avokati i tij, i dëmtuari, avokatët e të dëmtuarit, pala e tretë "G.K SHPK" (dhe palët tjera të treta) si dhe dëshmitarët dhe ekspertët të cilët gjykata vendos të merren në pyetje drejtpërdrejt me kërkesë të palëve ose sipas detyrës zyrtare, duke konsideruar se ka arsye për mbajtjen e seancës para Gjykatës së Apelit. Në kuptim të përcaktimeve të nenit 390.3 të KPP, në seancën e kolegjit pala e treta mbrojtësi i tij, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të kundërligjshme të gjykatës së shkallës së parë, do të kërkojnë shpjegimet e nevojshme lidhur me pretendimet në ankesë, si dhe propozojnë që në plotësim të lexohen dosjet e caktuara, ndaj të cilave do t'i jepet nga ana mbrojtësit të palës së tretë nëse ka nevojë për shpjegime për qëndrimet e tyre nga ankesa. Në kuptim të dispozitave të nenit 398 pika 2 të KPP Gjykata e Apelit të urdhërojë gjykatën themelore në Prishtinë-Departamenti Special, që të caktojë një gjyqtar të ri individual në bazë të një sistemi objektiv dhe transparent të shpërndarjes së lëndëve, duke pasur parasysh se gjyqtari në fjalë, si individ që ka marrë aktgjykimin e ankimuar, sepse në vazhdimësi ka zbatuar ligjin në mënyrë të paparashikuar, ka keqë vlerësuar shumë provat, gjë që çoi në zbatimin e gabuar të ligjit, ndaj palës së tretë "G.K SHPK". Në kuptim të dispozitave të nenit 403. paragrafi 1. nen paragrafi 1.1 i KPP që Gjykata e Apelit me aktgjykim ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, nëse konstaton se sa i përket palës së tretë "G.K SHPK". Gjykata themelore gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë i ka vërtetuar faktet dhe për këtë qëllim: me kërkesë të palës së tretë-G.K SHPK, dhe mbrojtësit të saj, ose duke vepruar sipas detyrës zyrtare të mbajë seancë për marrjen e provave të reja ose ri paraqitjen e provave me qëllim të vërtetimit dhe vlerësimit të fakteve materiale në mënyrë të përcaktuar.

M.B.G– J.B av. Florim Vërtopi, për shkak të vendimit për konfiskim të dobisë pasurore nga pala e tretë shumës prej 20,100,00€ (njëzet mijë e njëqind/euro), me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovojë në tërësi si të bazuar, dhe në bazë të nenit 398 par. 1.3 të KPP aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/2021, të datës 07.12.2022, të hartuar me datë 31.01.2023, ta anuloj dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës Themelore për rigjykim dhe vendim, apo në bazë të nenit 398 par.1.4, të KPP Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/2021, të datës 07.12.2022, të hartuar me datë 31.01.2023, ta ndryshoj duke urdhëruar Bankën Qendrore të Kosovës që nga llogaria e fondit në mirëbesim -----, shuma e konfiskuar prej 20.100.00 euro, ti kthehet, M.B.GSHPK me pronar J.B në llogarinë Pro Credit bankë me numër: -----.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, lidhur me ankesat e paraqitura, nga mbrojtësi i të pandehurit K.SH av. Florent Latifaj, dhe palët e treta: K SHPK – A.Z av. Eset Berisha, R.H - R.M av. Ethem Rogova, KF G.LL – B.B , G SHPK – H.Shav. Tomë Gashi, F.P CM – L.M.B , B.Sh, D.C SH.P.K - F.G, NTP N. – M.N, A.M.S – S.E av. Kushtrim Bytyqi, I.TH.M SHPK av. Shpresa Berisha-Rexhepi, E. SHPK – I.P av. Leutrim Syla, F.B – F E SHPK av. Blerim Mazreku, N.SH SH.P.K – M.P av. Prenk Pepaj, H-B SH.P.K. e NTPSH H - N.Hav. Sylë Hoxha, NTP X-T– B.T av. Naim Spahiu, dhe P.F SHPK-G.D , ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që ankesa e mbrojtësit të të pandehuri dhe palëve të treta të refuzohen si të pabazuara, dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/21, i datës 07.12.2022.

Prokuroria e Apelit me parashtresat, PPA/I.nr.208/2023, datë 05.04.2023, dhe PPA/I.nr.208/2023, datë 03.05.2023, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara përgjigjet në ankesë të Prokurorisë Speciale, dhe të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve, L.G av. Tahir Rrecaj e av. Selman Bogiqi, dhe K.SH av. Florent Latifaj, si dhe të gjitha ankesat e palëve të treta dhe përfaqësuesve të tyre, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, PS.nr.43/21, i datës 07.12.2022, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën kanë marrë pjesë, të akuzuarit L.G e K.SH, av. Tahir Rrecaj, av. Selman Bogiqi, av. Florent Latifaj, av. Florim Vërtopi, av. Ethem Rugova, av. Tomë Gashi, av. Blerim Mazreku, av. Kushtrim Bytyqi, av. Prenk Pepaj, av. Leutrim Syla, av. Sylë Hoxha, av. Nazmi Mustafati, palët e treta B.B , M.LL , dhe Mehmet Nalbani, kurse nuk ishte i pranishëm, Prokurori i Prokurorisë së Apelit, av. Eset Berisha, av. Shpresa Berisha, palët e treta LB, B.Sh, Dili Comerc, av. Naim Spahiu dhe G.D , edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi shpjeguan ankesat e tyre theksuan se mbeten në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, ndërsa të akuzuarit i mbështetën mbrojtësit e tyre, e gjithashtu palët e treta si dhe përfaqësuesit e autorizuar të palëve të treta pasi shpjeguan ankesat e tyre theksuan se mbeten në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim.

Gjykata e Apelit e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se ankesat janë të pabazuara.

### **Pretendimet ankimore:**

#### **Mbrojtësit e të akuzuarit L.G av. Tahir Rrecaj dhe av. Selman Bogiqi**

Lidhur me shkeljet esenciale të procedurës penale, pretendojnë se aktgjykimi i atakuar është marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 384, par.1 nënpar.1.12 lidhur nenet 370 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar nuk ka paraqitur arsytet për çdo pike të aktgjykimit, nuk ka paraqitur arsye të mjaftueshëm lidhur me pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në fjalën përfundimtare dhe të plotësuar edhe me sqarime shtese gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, po ashtu nuk ka vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësinë e provave kundërthënëse, arsytet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve dhe as arsytet në të citat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij (pika 4 e aktakuzës).

Mbrojtja vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë as edhe një arsye të vetme se ku e ka bazuar vlerësimin e saj se L.G e ka kryer këtë vepër penale në bashkëkryerje me të pandehurin K.SH. Sipas tij e gjitha bazohet në supozime dhe thashetheme të pavërtetuara L.G nuk e kundërshton faktin se ka bërë transferin e parave në llogarinë e "L-D-G", por ky kurrë nuk ka pasur ndonjë marrëveshje paraprake me të pandehurin K.SH që ato para të derdhen në llogaritë bankare të personave të trete. Gjykata e shkallës së parë i merr si të besueshme provat materiale, në veçanti transaksionet e parave në persona të tretë, e që sipas gjykatës se shkallës së parë, janë bërë me qëllim të maskimit të burimit të mjeteve monetare. Kjo edhe mund të ketë ndodhur, por i mbrojturi ynë as nuk ka qenë në marrëveshje me të pandehurin K.SH dhe as që ka ndërmarr çfarëdo veprimi të drejtpërdrejt apo të tërthortë për një transferim të tillë. Këtë vlerësim të gjykatës se shkallës së parë nuk e kanë vërtetuar asnjëri nga dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, e bile as vet i pandehuri K.SH, dhe nuk vërtetohet as me ndonjë prove materiale.

Sipas mbrojtjes gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e nenit 384 par. 2 shkelje e të drejtave të mbrojtjes që kane qenë me ndikim në marrjen e aktgjykimit jo të ligjshëm dhe jo të drejtë, lidhur me nenin 3, par. 1 të KPPRK-së - prezumimi i pafatajesisë së të pandehurit dhe in dubio pro reo, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkel të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo, për faktin se trupi gjykues edhe pse asnjëri nga dëshmitarët, por edhe me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar se z. Hoxha ka pasur për qëllim që OE fitues i tenderit të përfitoi dobi pasurore të kundërligjshme, të njëjtin e shpall fajtor vetëm në bazë të dyshimeve të ngritura kundër tij nga ana e prokurorisë.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal, mbrojtja konsideron se me rastin e marrjes së vendimit lidhur me fajësinë e të akuzuarit L.G për kryerjen e këtyre vepra penale Shpëlarja e parave nga Neni 302 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga Neni 56 i Ligjit nr. 05/1-

096 Për parandalimin e pastrim të parave dhe luftimin e terrorizmit, në bashkëkryerje me të akuzuarin K.SH, e që sipas mbrojtjes ka shkelur ligjin penal në dem të pandehurit, sepse nga gjendja e vërtetuar e fakteve nuk del se z. Gruda të ketë ndërmarr çfarëdo veprimi te drejtpërdrejt apo te tërthortë për kryerjen e veprës penale. Ne veçanti, gjykata e shkalles së parë me as edhe një provë të vetme nuk e ka vërtetuar ekzistimin e bashkëkryerjes dhe format e bashkëkryerjes. PS e ka akuzuar të pandehurin se këtë vepër penale e ka kryer ne bashkëkryerje me të akuzuarin K.SH, por për këtë pretendim ne vetin nuk ka paraqitur as edhe një prove të vetme.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në ankesë mbrojtja vlerëson se Prokuroria Speciale, as gjatë fazës së hetimit e as gjatë shqyrtimit gjyqësor, me as edhe një prove vetme nuk e ka vërtetuar pretendimin e vet të paraqitur në aktakuzë se i mbrojturi ynë të ketë ndërmarr çfarëdo veprimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me qëllim të kryerjes se kësaj vepre penale. Kjo nuk u vërtetua as gjate shqyrtimit kryesor, qoftë nga deklarimi i të pandehurit, K.SH apo nga dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimit gjyqësor, dhe as me provat materiale të administruara ne shqyrtimin gjyqësor. Për ta mbështet pretendimin e vet se të akuzuarit L.G dhe K.SH kanë vepruar në bashkëkryerje, PS i referohet vlerësimit të masave të fshehta-Regjistrimi i thirrjeve telefonike. Lisingut hyrje-daljeve dhe përmbajtës së sms-ve, mes L.G dhe K.SH duke paraqitur në aktakuzë, faqe 80/81, gjithsejtë gjashtë regjistrime telefonike në mes tyre, nga data 02 Tetor 2020 deri me dt. 13 Tetor 2020, në intervale të ndryshme kohore të cilat kane zgjatë nga 28 deri në 52 sekonda. Mbrojtja vlerëson se vetëm kontakti përmes telefonit në mes të akuzuarve, pa e ditur se për çfarë kanë biseduar, vetvetiu nuk i jep te drejtë PS qe të vjen në konkludim se këta kanë biseduar për ndonjë marrëveshje të përbashkët për kryerje të kësaj vepre penale. Gjukata e shkalles së parë nuk është dashtë që ta pranoj një vlerësim tille të PS, sepse është një vlerësim krejtësisht hipotetik dhe në fakt arbitrar.

Lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, mbrojtja vlerëson se gjykata e shkalles së parë, me rastin e marrjes se vendimit mbi sanksionin penale, nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat kanë qenë me ndikimi në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm. Ka shtuar se gjykata e shkallës së parë rrethanat rënduese i ka vlerësuar gabimisht, dhe po ashtu, i ka mbivlerësuar, ndërsa çuditërisht nga rrethanat lehtësuese ka vlerësuar vetëm pranimin e fajësisë dhe kërkim keqardhjen e shfaqur, duke injoruar në tërësi rrethanat tjera lehtësuese cilat janë te shumta në anën e të mbrojturit tone, e që si rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit, shkeljen e besimit që i është dhënë në bazë të detyrave të punës zyrtare, shkeljen e besimit të kolegeve te tij, duke krijuar qasje në sistem në emrat e tyre. Mbrojtja vlerëson se asnjëra nga këto rrethana nuk mund merret dhe të vlerësohet si rrethanë rëndues, për faktin se të gjitha këto veprime paraqesin elemente qenësore qe përbejnë figurat e veprave penale për te cilat është akuzuar i akuzuari. Tutje shton se gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar dispozitat mbi zbutjen e dënimit, edhe pse në rastin konkret kanë ekzistuar të gjitha kushtet ligjore për zbutjen e dënimit, në veçanti duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë është rrethanë veçanërisht lehtësuese, e cila rrethanë së bashku edhe me rrethanat tjera lehtësuese ka qenë me ndikim që gjykata të shqiptoj dënim më të butë me burgim, andaj nga të sipër cekurat propozon si më lartë.

**Mbrojtësi i të akuzuari K.SH, av. Florent Lafatitaj**

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, par. 1, nënpar. 1.12 dhe par. 2, nënpar. 2. 1, lidhur me nenin 370 par. 7 të KPPK, i cili shprehimisht kërkon që gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara si dhe neni 361 par. 2 të KPK-së, ku gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe lidhur me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr përfundim nëse fakti konkret është provuar, e që në rastin konkret konsideron se mungon një vlerësim dhe analizë e provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nuk ekziston as edhe një provë e vetme e cila do të vinte në përfundim se ka pas një marrëveshje në mes dy të pandehurve. Gjykata, ka tentuar në këtë kontekst të arsyetojë lidhjen në mes tyre nga fakti se ata kanë rastisë me qenë më një aeroplan gjatë kthimit nga Turqia e të cilët kanë qenë në udhëtim për arsye të ndryshme secili. Ndërsa vetë provat nga prokuroria konstatojnë se i bashkëpandehuri ka rezervuar biletën në Raisbiro Dituria dhe atë nga Shkupi, gjersa i mbrojturi im ka udhëtuar nga Prishtina. Shkuarja në Turqi K.SH me L.G Gruden pra së bashku vet kjo prokurori në faqen dhjete te fjalës përfundimtare thotë "me datë 13.10.2020 nga Raisbiro Dituria-L.G kishte rezervua dhe paguar biletën një drejtim pra Shkup Stamboll e ndërsa K.SH thotë ka shkuar nga Prishtina. Tani ndërlidhja e bashkëveprimit në kryerjen e veprës penale vetëm nga fakti e kanë qenë së bashku në aeroplan gjatë kthimit është tërësisht i pabazuar. Kurse sa i përket dhënien e të dhënave financiare nuk mund të ndërlidhet ndihma në kryerjen e kësaj vepre nëse e shihni edhe vet fjalën përfundimtare të prokurorit të cilën e ka dorëzuar me shkrim në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ky subjekt (L-D-G) ka qenë edhe me herët i regjistruar në organet shtetërore, se i janë bërë pagesa për punë që janë krye me herët, do të thotë se në të dhënat e L-D-G kanë pas qasje te gjithë institucionet shtetërore. Kështu gjykata në asnjë rast nuk është lëshuar që të argumenton faktet se a është e mundur që një person (i cili nuk është zyrtar) ti jep ndihmë një zyrtari për kryerjen e një vepre e cila lidhet me detyrën zyrtare. Për mbrojtjen kjo nuk mund të qëndron, ngase kjo vepër penale lidhet drejtpërdrejt me detyrën zyrtare, edhe ndihma mund të jepet vetëm nga personi zyrtar e jo nga dikush tjetër. Gjithashtu gjykata nuk jep përgjigje në atë se kemi para të transferuara nëpërmjet llogarive bankare, nga një llogari bankare në tjetrën dhe se parat nuk i ka transferuar i mbrojturi im por personi tjetër i bashkëpandehuri tek i mbrojturi im, pra ato para veç se kanë qenë në llogari bankare, atëherë si mundet i mbrojturi im të ngarkohet me pastrim parash, apo ndoshta gjykata ka menduar se pse i ka transferuar pasi i kanë dalur në llogari!.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal pretendohet se me veprimet e të pandehurit nuk përmbushen elementet e veprave penale për të cilën është shpall fajtor i pandehuri. Si mundet të konstatohet ndihma kur vet prokurori thotë se kjo kompani i ka pasur të dhënat pranë organeve shtetërorë e me pas thuhet se K.SH ja ka dhënë këto të dhëna e gjithashtu se cilësia e K-Sha a mund të jetë në rastin konkret e personit që mund të kryej veprën penale të ndihmës personit zyrtar. E edhe Pastrim i Parave këtë rast është shkelur ligji penal në dëm të të mbrojturit tim ngase për të njëjtin thuhet për të cilat thuhet se kanë tentuar ti pastrojnë duke i transferuar nëpër llogari bankare e që në dukje disa duken fiktive. Pra gjykata nuk e di se a janë apo nuk janë fiktive por se disa i duken.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pretendon se në rastin konkret vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike shprehet në faktin se gjykata ka vërtetuar gabimisht faktet

kryesore, në fakt ka vërtetuar faktet kryesore duk u mbështetur në prova rrethore gjë që argumentimi juridik nuk duron. Është e qarte dhe e mundur të vërtetohen fakte rrethore nga provat direkte por jo e kundërta, prandaj nëse thuhet se është vërtetuar ndihma në kryerjen e veprës penale duke cekur se ata kanë qenë në të njëjtin aeroplan nga Stambolli për në Prishtinë është krejt e paqëndrueshme për argumentim të elementeve të veprës penale.

Lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është tejet i rëndë. Prandaj, shqiptimi i një dënimi tepër të rëndë është i paarsyeshëm, e sidomos kur për të njëjtën veprë penale pra të Pastrimit të parave L.G i jepet dënim në pothuajse përgjysmë me i ulët se të mbrojturit tim, e ku për veprën bazë ky dënohet për ndihmë. Andaj, edhe në këtë rast gjykata ka dështuar të vlerësoj në mënyrë të drejt rrethanat lehtësuese me rastin e matjes së dënimit por ka konstatuar se i njëjti ka qenë i dënuar më parë (edhe pse për një veprë të natyrës krejt tjetër) kështu që nuk ka gjet rrethana lehtësuese. Kjo nuk është e mjaftueshme që një të akuzuari mos ti vlerësohet asnjë rrethanë lehtësuese sepse paska qenë i dënuar më parë për një veprë të një natyre krejt tjetër.

### **Ankesat e palëve të treta**

**F.P CM, me përfaqësuese L.M.B**, në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar ka shkelje të dispozitave ligjore, me të cilat konsideron se është dëmtuar nga ky aktgjykim duke pësuar dëme të mëdha e të pa riparueshme. Ka shtuar se si biznes operon që një kohë të gjatë dhe se asnjëherë deri më tani nuk pasur ndonjë raport afatarist - shitje blerje me K Shalen, por është shumë e vërtet se K.SH ka huazuar nga bashkëshorti im B.B shumen prej 80,000.00€, që në vitin 2018. Me rastin e kthimit të huazimit, atëherë bashkëshorti ka transferuar shumen e lartëcekur në llogari të firmës që unë e përfaqësoj se bashku me të njëjtin me qëllim që ti paguajmë obligimet që kemi ne ndaj furnitorve tjerë. Tutje ka shtuar se nga dita e fillimit të hetimeve nga ana e Prokurorisë Speciale kundër këtu të akuzuarit K.SH e deri më tani, vërtet është bërë padrejtësi ndaj firmës time dhe meje sa i përket marrjes së urdhrit për ngrirjen e xhirollogarisë së firmës të cilën e përfaqësoj unë, madje shkeljet kanë vazhduar edhe me rastin e marrjes së urdhrit ndalues dhe urdhrit për ndalim afatatgjatë të aseteve nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, të cilët urdhra unë vazhdimisht i kam kundërshtuar duke argumentuar me prova materiale se nuk ka asnjë bazë të na sekuestrohet shuma e kërkuar e asesi të bllokohet e tërë xhirollogaria e firmës duke na pamundësuar që të vazhdojmë me zhvillimin e punimeve nga biznesi jonë i cili ishte i rregullt, i regjistruar dhe për të cilin ne paguanim dhe vazhdojmë të paguajmë taksa Republikës së Kosovës. (deklarata mbi huazimin gjendet në shkresat e lëndës) Pretendimet tona fare nuk i ka marrë në konsideratë Prokuroria Speciale e as Gjykatësi i procedurës paraprake edhe për kundër faktit se ndaj meje me autorizimin e prokurorisë janë zhvilluar kontrollet nga ATK dhe se sipas raportit përfundimtar ka rezultuar se unë nuk kemi asnjë shkelje ligjore. Në ankesë thekson se nga shkresat e lëndës vërtetohet se nga K.SH unë nuk kam asnjë transfer të drejtpërdrejt dhe se për mua është e pa kuptueshme se mbi bazën e cilave fakte dhe prova gjykata vendosi konfiskimi e mjeteve financiare. Arsytimi i mëtejme i gjykatës së shkallës së parë është në drejtim se për arsyeje që palët e treta nuk kanë ditur se paratë janë burim i aktivitetit kriminal ka lehtësuar pozitën e tyre procedurale apo ju ka dhënë cilësia e palës së tret, përndryshe po te dinin se këto para rrjedhin nga aktiviteti kriminal do të inkriminoheshin edhe ato. Në aktgjykimin e ankimuar thuhet se ka deklaruar se kinse një pjesë e mjeteve të transferuara nga B.B , unë ti kam shfrytëzuar për mbylljen e overdrasfatti, kjo nuk qëndron dhe se nuk ka asnjë provë që unë



ta kam mbyllë overdrafattin, përkundrazi overdrafatti është aktive. Ky arsyetim është më tepër se arsyetim, por fare nuk qëndron, prokuroria intenzivisht ka zhvilluar hetime në këtë drejtim dhe se nuk ka gjetur asnjë element të vetëm që do ta ndërlidhte biznesin tim. Vendosija e gjykatës për konfiskimin e shumës se mjeteve prej 13,932.34 është bërë me shkelje absolute të dispozitave ligjore, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**B.Sh.**, pretendon se aktgjykimi i ankimuar ka kundërbërje në mes të arsytimit dhe dispozitivit të aktgjykimit dhe shkelje të dispozitave ligjore, me të cilat konsideron se është dëmtuar nga ky aktgjykim duke pësuar dëme të mëdha. Ka shtuar se të akuzuarin K.SH e ka vëlla dhe se me të njëjtin kanë jetuar në bashkësi të gjerë familjare deri në viti 2016, në fshatin Llapushnik, Komuna Drenas. Në vitin 2016 më vëllezërit tjerë e kanë bërë edhe ndarjen e pasurisë së përbashkët sipas dokeve dhe zakoneve tona. Me rastin e pjesëtimit të pasurisë K.SH ka mbetur tek unë borxh shumen 26,000.00€ të cilën i njëjti nuk kishte mundësi të mi paguante. Nga të mirat materiale që K.SH kishte unë nga i njëjti kamë pranuar veturën Taureg për vlerë 6,000.00€, ndërsa pjesën tjetër prej 20,000.00€ i njëjti sipas tij i ka paguar përmes transferit, të gjitha i ka bërë në emër të obligimit që kishte me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët. Tutje ka shtuar se vetura në fjalë nuk ishte as mjet me të cilin është kryer vepra penale e dyshuar, e as nuk ishte e mira materiale e fituar nga vepra penale e dyshuar, pra nuk kishte bazë për sekuestrim sipas nenit 112 par 1 dhe 2 të KPPK-së. Sipas tij nga dita e fillimit të hetimeve nga ana e Prokurorisë Speciale kundër këtu të akuzuarit K.SH e deri më tani, është bërë padrejtësi ndaj meje si palë e tretë me rastin e sekuestrimit të tani konfiskimit të veturës, duke theksuar se asnjëherë për asnjë qastë nuk kam fshehur asgjë me rastin e dhënies së deklaratave të mija në polici dhe prokurori si dhe gjykatë duke i argumentuar ato me qëllimin e vetëm që të vërtetohet fakti që vetura nuk është as mjet e as përfitim nga kjo vepër e dyshuar dhe kam kërkuar që mos të sekuestrohet, por fare nuk kamë besuar që pa prova do të konfiskohet nga gjykata e shkallës së parë. Në ankesë ka theksuar se edhe pse K Shalen e ka vëlla me të njëjtin nuk kamë pasur asnjë transfer apo raporte afatariste, përjashtim faktit që i njëjti ka paguar borxhin që ka mbetur me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët. Duke shtuar se prokuroria intenzivisht ka zhvilluar hetime në këtë drejtim dhe se nuk ka hezituuar e as kursyer asgjë por se nuk ka gjetur asnjë element të vetëm që do ta krijonte lidhjen kauzale mes meje dhe të akuzuarve dhe se nuk ka pasur se si të më përfshinte në aktakuzë, andaj duke pasur parasysh se unë asnjëherë nuk kam qenë i dyshuar, i pandehur dhe i akuzuar si ka mundësi dhe mbi bazën e cilës dispozitë ligjore gjykata ka marrë këtë aktgjykim të cilin kategorikisht e kundërshtoj se vërtet është i pa bazuar, dhe se vetura ime është marr vetëm pse dikur shumë kohë para se të hetohet vëllau im K.SH, e ka pasur në pronësi dhe se për arsyeje të barazimeve të pasurisë së përbashkët nga ndarja me ka kaluar mua, andaj nga të sipër cekurat ka propozuar si me lartë.

**D-CO"SH.P.K"**, konsideron se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje ligjore dhe atë në bazën të përcaktuara me nenin 383 pika 4 të KPP-së. Aktgjykimi nuk është i ligjshëm dhe as i drejtë, ngase gjykata nuk ka arrit që në këtë çështje penale të zbatojë drejtë dispozitat ligjore, vendimit lidhur me sanksionin penal e që kjo ka bërë që aktgjykimi si i pa ligjshëm në këtë pjesë të jetë në dëm të palës së tretë subjektit ekonomik ndërmarrja C-COSH.P.K. Gjykata duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore ka nxjerr aktgjykim të kundërligjshëm nga se vendimin nga se nga provat që janë administruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar se pasuria që gjendet tek pala e tretë subjekti ekonomik ndërmarrja " D-CO" SH.P.K nuk mund të

i nënshtrohet konfiskimit nga se nuk është pasuri e fituar drejtpërdrejtë si rezultat i veprës penale për faktin se pala e tretë ka kryer punë për çka edhe të njëjtit i ka faturuar, gjithashtu fakti se Ndërmarrja "D-CO" SH.P.K, nuk është i dyshuar e as i akuzuar për përfshirje në veprën penale. E po ashtu posedimi i pasurisë nuk është bërë përmes ndonjë vepre penale, por me punë të ligjshme juridike në emër të shitblerjes së materialit ndërtimore me faturë të rregullt apo thënë ndryshe është pasuri nga raporti kontraktual (i shit-blerjes). Tutje ka shtuar se me rastin e konfiskimit, ndërmarrjes Ndërmarrja "D-C" SH.P.K, i është shkaktuar dëm i dyfishit pasi që fillimisht të njëjtës nuk i është njohur cilësia e palës së dëmtuar por e palës së tretë, i është pamundësuar zhvillimi i transaksioneve përmes llogarisë së saj për shkak të bllokimit dhe mjetet që i ka pranuar në emër të mallit të shitur i janë konfiskuar. Gjykata e shkallës së parë, është dashur që të kujdesët zyrtarisht në mënyrë që mos ti dëmtoj palët e treta, andaj nga të sipër cekurat propozon si më lart.

**N.SH Sh.p.k, me përfaqësues av. Prenk Pepaj**, në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë cenim të rëndë të dispozitave të procedurës penale, meqenëse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është kundërthënës me arsyetimin, se nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe se ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjeve të shkresave të lëndës dhe procesverbaleve ka kundërthënie dhe vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve. Provat e administruara fare nuk janë vlerësuar dhe se nuk ka pasur asnjë arsye që gjykata lidhur me këto prova të mos japë vlerësimin e sajë të drejtë dhe të bazuar në ligj sa i përket NTSH "Shef" Sh.pk. me seli në Gjakovë. Tutje ka shtuar se aktgjykimi i ankimuar ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, meqenëse gjatë procedurës nga ana e gjykatës nuk është proceduar pronari i ndërmarrjes, meqenëse datën kur është ftuar i njëjti nuk ka mundë të prezantojë në të njëjtën seancë. Në rastin konkret, është e vërtetë se nga ana e L-D-G, me seli në fsh.Llapushnik Glllogovc, tek NTSH "Sefqet", Sh.p.k., me seli në Gjakovë, është blerë mall dhe atë Cemnet 42.5 Shrcem, në shumë prej 2.288.00 Euro, Manta Milis 12X428X5, në shumë prej 1.179, Blok Kid ALB 19X19X24, në shumë prej 233.45 Euro dhe Sharmall Sharcem në shumë prej 1.300.00 Euro, apo në shumë të përgjithshme prej 5.000.81 Euro. Lidhur me këtë NTSH "Shfeqet" Sh.p.k, blerësit i ka lëshuar pro-Faturën Nr.21 me datë 12.10.2020 dhe Faturën nr.A/1089-E, me datë 13.10.2020. Kurse nga dispozitivi i aktakuzës faqja 7 (41) numri rendorë në tabelë rubrika 15, rezulton se L-D-G, i ka paguar NTSH "Shef", me seli në Gjakovë, shumën prej 5.00.81 Euro, sipas Fatures nr.600094776. Për shkak të shkeljeve të sipër cekuar të dispozitave të procedurës penale, gjykata e shkallës së parë bënë edhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, në raport me NTSH "Shef", me seli në Gjakovë. Si rezultat i vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës penale, ka ardhur edhe gjerë te aplikimi i gabuar i së drejtës materiale dhe vendimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore në raport me NTSH "Shef" Sh.p.k., me seli në Gjakovë, andaj nga të sipër cekurat propozon si më lart.

**P.F SHPK, me pronar G-D**, në ankesë pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, është i pa kuptueshëm, dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë. Dispozitivi si pjesë esenciale e aktgjykimit duhet të përmbaj jo vetëm kualifikim ligjor të veprës penale por gjithashtu edhe një përshkrim të detajuar e preciz të të gjitha fakteve relevante si dhe rrethanave vendimtare të cilat janë bazë për aplikimin e dispozitave ligjore. Ka shtuar se nga fatura e subjektit ekonomik P.F SHPK me seli në fsh. Sojevë Komuna e Ferizajt të cilës me aktgjykimin e ankimuar nga

xhirollogaria i konfiskohen 6,722.25 Euro të cilat i ka në posedim konform Faturës nr.1042020 e datës 01.04.2020 me të cilën vërtetohet fakti se ka kryer shërbime rritjen e zogjve për pula vojse, duke bashkangjitur si provë fotokopjen e faturës nr. 1042020 e datës 01.04.2020. Po ashtu nga raporti bankar vërtetohet fakti se nga F.P CM me seli në fsh. Arllat Komuna Gllogoc pronare e të cilës është znj. L.M.B 14.10.2020 është kryer transferi bankar në emër të P.F SHPK me seli në fsh. Sojevë Komuna e Ferizajt duke u paguar obligimin sipas Faturës nr. 1042020 e datës 01.04.2020, bashkangjitur me ankesë provën fotokopjen e transferit bankar të datës 14.10.2020. Si përfundim ka shtuar se bazuar në transferin e kryer subjekti ekonomik P.F SHPK, e cila veprimtari ka rritjen e zogjve për pula vojse si dhe njësinë për pula vojse është palë e katër sepse pala e tretë F.P CM me seli në fsh. Arllat Komuna Gllogoc pronare e të cilës është znj. L.M.B e cila mi ka bart mjetet financiare në emër të obligimit për rritjen e zogjve, çka nënkupton se jam pala e katërt. Prandaj, e kundërshtojë aktgjykimin e ankimuar sepse me asnjë provë materiale apo fakt konkret gjykata nuk ka vërtetuar rrethanën se unë jam pale e tretë ashtu që të më konfiskohet dobia pasurore e fituar nga vepra penale e cila pasuri gjendet në posedim tek unë, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lart.

**G SHPK – H.Sh av. Tomë Gashi**, në ankesë pretendon se në rastin konkret kemi mos përpërbajtje te përmbajtjes te aktgjykimit kundër te cilit po paraqitet kjo ankesë dhe te procesverbalit te shqyrtimit gjyqësorë te datës 23.11.2022, ku gjykata krejtësisht ne mënyrë te gabuar e ka cituar deklaratën e z. H.Sh dhe me këtë e ka ndryshuar kuptimin e deklaratës se tij ndërsa është e qarte se ai nuk ka pasur kurrfarë raporte biznese me asnjërin prej kompanive te te akuzuarve ne këtë çështje penale. Gjykata gabimisht e ka përshkruar deklaratën e z. H.Sh dhënë ne shqyrtim gjyqësorë, sepse z. H.Sh ka deklaruar se kurrë nuk ka pas marrëdhënie biznese me "L-D-G" e as qe i njeh pronaret e kësaj kompanie dhe se ka pasur marrëdhënie biznese me kompaninë "---", e kjo vërtetohet edhe nga raporti i kontrollit te ATK-se date 09.12.2021 ku janë analizuar dhe verifikuar transaksionet e shitjes ne mes te subjektit-biznesit "G SH.P.K" dhe subjektit "---" ku ATK-ja me ane te kontrollit nuk kanë konstatuar ndryshime mes tatimpaguesit dhe kontrollit qe do te thotë se faturat kanë qene te rregullta si dhe produktet e "G SH.P.K" i janë shitur subjektit "---" me çmime te tregut, kështu që me këtë gjykata ka bere shkelje esenciale te KPPRK-se nga neni 384 al. 1 pika 1.12 ngase arsyetimi nuk është përpiluar fare me pajtim me nenin 370 pika 6 dhe 7 te KPPRK-se respektivisht ajo qe është shkruar ne këtë aktgjykim nuk i përputhet deklarimit te z. H.Sh te cilin e ka dhënë ne shqyrtimin gjyqësorë date 21.11.2022. Aktgjykimi i gjykatës po ashtu është sjelle me vërtetim te gabueshëm dhe jo te plote te gjendjes faktike ne raport me kompaninë "G SH.P.K" respektivisht me pronarin H.Sh me rastin e konfiskimit te dobisë pasurore ngase z. H.Sh respektivisht kompania e tij "G SH.P.K" ne rastin konkret kompania "G SH.P.K" i ka shitur produkte qe ajo i prodhon, me mirëbesim dhe me çmime reale e kjo është vërtetuar nga raporti i kontrollit i ATK-se date 09.12.2021 i cili kontroll është kryer për shkak te transaksioneve-shitblerjes se produkteve qe i prodhon kompania "G SH.P.K" e te cilat i ka shitur kompanisë "G-C" me pronar G G dhe se me raportin e kontrollit te ATK është konstatuar se "duke u bazuar ne arsyet e caktimit te rastit për kontroll - objekt kontrolli verifikimi i transaksioneve te shitjes me subjektin "G-C" me ane te kontrollit nuk kemi konstatuar ndryshime mes deklarimit te tatimpaguesit dhe kontrollit", andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**H-B SH.P.K. e NTPSH H - N.H av. Sylë Hoxha**, pretendon se N.H si pronarë i "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H, dhe mua si përfaqësues nuk na është dorëzuar nga ana e gjykatës as urdhri ndalues afatatgjatë, i cili është ankimuar. Përkundër faktit se afat i paraqitjes rrjedh nga data e lëshimit të urdhrin, ne asnjëherë zyrtarisht nuk kemi pranuar urdhrin. Të njëjtin urdhër e kemi siguruar nga njëri nga kolegët avokat, i cili përfaqësojnë njëren nga kompanitë-palë të interesit. Gjykata, në këtë mënyrë ia ka pamundësuar "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H që ti paraqesin në mënyrë adekuate pretendimet e tyre dhe ofrimin e provave përkatëse që mbështesin pretendimet e tyre. Është e qartë dhe e pakontestueshme për gjykatën ashtu si për prokurorinë (që nuk e ka përfshirë si të akuzuar palën e tretë "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H) se transaksioni në mes të L-D-G SHPK dhe palës së tretë "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H ka qenë i ligjshëm dhe nuk ka qenë transaksioni i vetëm. Pra, "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H kishte pranuar edhe pagesa të tjera, para kohës kur është pretenduar të jetë kryer vepra penale nga të akuzuarit. Kjo e vërteton faktin se "H-B" SH.P.K. dhe NTPSH H as nuk e kanë ditur, e as nuk kanë pasur si të dijë për prejardhjen e pasurisë me të cilën është paguar malli elektrik i blerë dhe marrë nga L-D-G SHPK pas blerjes së tij, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**NTP X-T – B.Tav. Naim Spahiu**, pretendon se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore me konfiskimin e mjeteve monetare në posedim të palëve të treta konkretisht paraqitësit të ankesës B.T t është në kundërtënie me arsyetimin edhe se nuk përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike relevante për të marrë një vendim të tillë për mjetet monetare të ngnra sipas urdhëresës së gjykatës. Këto kundërtënie më së miri vërehen kur të analizohen shkresat e lëndës, si dhe nuk janë marrë për bazë provat të cilat i ka dorëzuar mbrojtësi i palës së tretë të interesuar në këtë çështje, e që kanë pasur të bëjnë me rastin konkret. Konfiskimi është bërë pa ndonjë bazë ligjore për arsyeje se mjetet të cilat janë objekt i konfiskimit nuk kanë të bëjnë fare me veprën penale të gjykuar. Gjykata ka bërë shkeleje të dispozitave të KPPK-së, ku vendimin për konfiskim e ka marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 278 të KPPK. Kështu është e qartë dhe e pakontestueshme për gjykatën se transaksioni në mes të F.P CM -L.M.B dhe palës së tretë "N.T.P "X-T" ka qenë i ligjshëm dhe nuk ka qenë transaksioni i vetëm. Pra, "N .T.P "X-T" kishte pranuar edhe pagesa të tjera, para kohës kur është pretenduar të jetë kryer vepra penale nga të akuzuarit. Kjo e vërteton faktin se "N.T.P "X-T" as nuk e ka ditur, e as nuk ka pasur si të dijë për prejardhjen e pasurisë i marrë nga F.P CM —L.M.B pas blerjes së tij. Në rastin konkret, "N.T.P "X-T" i bie të mos ketë në posedim as mallin e shitur, e edhe paratë me të cilat është paguar ai mall, të i merren. Gjykata ka dështuar të tregoj arsyen se pse këto mjetet llogariten si mjete nga vepra penale kur Administrata Tatimore e Kosovës me raport ka konstatuar se faturat e lëshuara nga ana e Biznesit X-T janë konform legjislacionit në fuqi dhe janë të rregullta. Mjetet e marra nga ana e F.P CM —L.M.B janë të ligjshme dhe se borxhi ishte në momentin e ndodhjes, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**NTP N. – M.N.**, pretendon se urdhërata për ngrirjen e xhirollogarisë bankarë të firmës NTP N. vazhdimisht i kam kundërshtuar dhe nuk jam pajtuar asnjëherë por se vërtet si propozim për gjyqtarin e procedurës paraprake ishte qëndrimi im dhe i disa palëve të treta që të bllokohen vetëm shuma e pretenduar e jo e tërë xhirollogaria e firmës duke argumentuar me prova materiale se nuk ka asnjë bazë të na sekuestrohet shuma e kërkuar e asesi të bllokohet e tërë xhirollogaria e firmës duke na pamundësuar që të vazhdojmë me zhvillimin e punimeve nga biznesi jonë i cili

ishte i rregullt, i regjistruar dhe për të cilin ne paguanim dhe vazhdojmë të paguajmë taksa Republikës së Kosovës. Pretendimet e tona nuk i ka marr parasysh fare PSK e as Gjykata, kurse nga kontrollat e ATK ka rezultuar se si përfaqësues i NTP Nallbanit nuk kemi asnjë shkelje ligjore. Arsyetimi si në faqen 40 të aktgjykimit nuk qëndron, ngase lidhur me shumën e mallit në vlerë prej 26,000.00€ kemi dërguar mall tek LDA Grupi, ashtu që nëse ne mesin e palëve te treta ka biznese që nuk kane dërguar mall dhe nuk kane kryer shërbime për LDA-grupin e në anën tjetër kane pranuar pagese nga LDA Grup, kinse për mallin e dërguar apo shërbimin e kryer, është obligim ligjor i organeve te ndjekjes por nuk mund që biznesi im te përfshihet në të njëjtën situatë, pra gjykimi-paragjykimi i përgjithësuar nuk është i pranueshme për ne, as i lejuar për gjykatën, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**A.M.S – S.E av. Kushtrim Bytyqi**, pretendon se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se klienti im ka pasur raport bashkëpunimi, ose bashkëveprimi me të dënuarit për kryerjen e veprave penale që atyre u vihet në barrë. Kështu pronari i kompanisë ka nxjerr dokumentet e transaksionit me kompaninë G.K SH.P.K. dhe në bazë të tyre vërtetohet se kjo blerje është e rregullt sipas dispozitave ligjore në vendin tonë, pasi që blerësit i është lëshuar profatura, ai ka realizuar pagesën përmes bankës, pastaj kompania i ka lëshuar faturën dhe blerësi ka tërhequr mallin, e që vërtetohet edhe nga përbajtja e faturës dhe pro faturave, andaj gjykata fare nuk i shqyrtuar këto prova në mënyrë që të arrijë deri tek një konstatim i drejtë i gjendjes faktike. Gjykata e ka bazuar aktgjykimin e atakuar, respektivisht konfiskimin e ka bazuar në nenin 276 dhe 278 të KPPRK-së, lidhur me nenin 92 të KPRK-së, mirëpo konsiderojmë se ka shkelur pikërisht këtë dispozitë ligjore sepse nuk i ka zbatuar asnjë nga kriteret e përcaktuara në mënyrë që të arsyetoj konfiskimin, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**I.TH.M SHPK av. Shpresa Berisha-Rexhepi**, pretendon se si palë e tretë në Aktgjykim PS.43/21 dt. 07.12.2022 është përfshi edhe personi juridik, "ISOTHERM MUJA" SH.P.K. ndaj të cilit, me datë 25.11.2020 ishte lëshuar urdhër ndalues afatgjatë për ngrirje të xhirollogarive me nr. 2200130100053407 në Zirat Bank. Konsiderojmë që vendimi i gjykatës është marr me shkelje të rënda të dispozitave të procedurës penale të KPPK nga se dispozitivi në par. 6 f. 11 është i paqartë, kontradiktor dhe i mangët, është po ashtu në kundërshtim, ngase gjyqtari i procedurës paraprake kishte lëshuar urdhër ndalues duke e aprovuar kërkesën për urdhër ndalues të aseteve - xhirollogarive bankare me shenjën PPS.nr.88/2020 dt. 26.10.2020 si dhe dt.03.11.2020 e 17.11.2020 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ndaj të pandehurve L.G dhe K.SH, ndërkaq për palët tjera kishte konfirmuar ndalimin e urdhrit afatgjatë për ngrirjen e xhirollogarive bankare, kurse neni 264 par. 1 i KPP-së përcakton vetëm tërheqjen nga llogaria bankare e jo siç kishte vendos gjykata ngrirjen e xhirollogarive. Tani me Aktgjykimin PS.43/21, dt. 07.12.2022 dhe as me ndonjë Vendim të posaçëm, gjykata nuk e ka hequr Urdhrin ndalues afatgjatë për ngrirjen e xhirollogarive bankare, kështu mjetet janë konfiskuar mirëpo llogarit bankare me urdhër kanë ngelur të ngrira. Në kundërshtim me nenin 264, par. 1 të KPPRK-së, gjyqtari i procedurës paraprake i kishte barazuar asetet me xhirollogaritë bankare dhe tani pa vendim të gjykatës qëndrojnë ende të ngrira, kështu gjykata me aktgjykim i ka konfiskuar mjetet monetare të ngrira duke i lënë të ngrira xhirollogarit

bankare, prandaj edhe gjendja duhet të ndryshohet në raport me palët e treta, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**KF G LL– B.B.**, pretendon se të akuzuarin Shala e kam dajë dhe se me të njëjtin kamë pasur raporte të huazimit ku unë i kam huazuar vite më parë një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare të cilat të njëjtit i janë dashur për realizimin e projektit të ndërtimit të shtëpive për riatdhësuarit (te njohura për organet e shtetit) dhe se me rastin e dhënies së deklaratës në polici, prokurori dhe deklarimeve te mija në gjykatë kamë dëshmuar përmes marrëveshjes me shkrim për huadhënien, kurse mjetet e transferuara nga K.SH në emër të donacionit nuk kanë të bëjnë asgjë me mua dhe nuk më përkasin mua por të klubit dhe se kërkojmë që ti kthehen klubit. Kështu L-D-G ka transferuar shumën në fjalë, unë nuk kam ditur dhe nuk kam mundur ta pyes jo LDA Grupin por asnjë nga donatorët eventual që mundë të jenë se nga kanë rrjedhë parat, unë konsideroj se konfiskimi është i pa drejt dhe për here te parë që ka ndodhë ne Republikën e Kosovës ne mënyrën dhe formën si në rastin konkret, kur tani dihet që KF nuk është i imi dhe se unë skam asnjë përfitim, pra është dëmtuar KF G.LL, dëmi ekonomik është i lartë për klubin edhe ashtu në gjendje te mjerueshme ekonomike që ndodhemi dhe se kërkoj që shuma e konfiskuar ti kthehet klubit, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**K SHPK – A.Z av. Eset Berisha**, pretendon se në bazë të provave të dorëzuara mund të shihet se kjo ndërmarrje si veprimtari kryesore ka realizimin e punëve ndërtimore për ndërtim të shtëpive, objekteve, kryesisht punë te suvatimit, gëlqerosjes dhe ngjyrosjes. Në muajin shtator të vitit 2019, kompania K sh.p.k dhe L-D-G nga fsh. Llapushnik, Drenas, kanë nënshkruar kontratë për kryerjen e punëve ndërtimore (suvatim, gëlqerosje dhe ngjyrosje), e që vërtetohet edhe nga përmbajtja e kontratës e dorëzuar në seancën e dt. 24 nëntor 2020 Gjykatës the Prokurorisë, ndërkaq duke u bazuar në këtë kontratë, palët kontraktuese i kanë përmbushur të gjitha të drejtat edhe detyrimet e tyre, e që vërtetohet edhe nga përmbajtja e fotove. Andaj mjetet e pranuar përmes transaksioneve monetare në llogarinë bankare të ankuesit nga kompania L-D-G rrjedhin nga një punë e vlefshme juridike. Nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit, vërtetohet se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike, fare nuk e ka vërtetuar bazën juridike të pagesës së pranuar nga ankuesi nga i pandehuri K.SH. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar asnjë provë me anë të së cilës do të vërtetohej vendimi i gjykatës për konfiskim të dobisë pasurore të palës së tretë të fituar në mënyrë të ligjshme nga i pandehuri, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**M.B.G– J.B av. Florim Vërtopi**, me datë 03.12.2020, J.B - M.B.GSHPK ka dorëzuar ankesën kundër urdhrin afatatgjatë PPPS 38/20 të dt.25.11.2020. Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin PN.S.nr.1/2021, te dt.09.02.2021 ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të palëve të treta, mirëpo në dispozitiv të këtij aktvendimi shihet se nuk është vendosur për ankesën e ushtruar në afat n ligjor te J.B -M.B.GSHPK. Nga provat në shkresat e lëndës, argumentohet se nuk ka ekzistuar asnjë arsye konkrete që mund të arsyetoj lëshimin e urdhrin nga gjykata themelore, për konfiskimin e aseteve në shumë prej 20,100.00 euro, nga xhirollogaria e M.B.GSHPK me pronar Jeton Bytyqi. Për konfiskimin e këtyre aseteve duhet të ekzistojnë prova të artikuleshme "përtej dyshimit të bazuar", respektivisht në rastin e J.B nuk ka pas dhe nuk ka asnjë provë e cila mund të argumentojë "përtej dyshimit të bazuar, në mënyrë që të bëhet konfiskimi i shumës prej

20,100.00 euro, prandaj me të drejtë pretendojmë pa mëdyshje, se urdhri për konfiskim nuk mbështetet në prova materiale si dhe është në kundërshtim të plotë, me nenin 92 të KPRK, 116 par.1, 276, 278, 279 dhe 284, të KPP në raport Jeton Bytyqin i cili është pronar i M.B.GSHPK. Nga „G-Ce Shpk" me seli në Suharek, me datë 13.10.2020 M.B.GSHPK, me pronar Jeton Bytyqin ka pranuar shumën prej 20.100,00 euro përmes llogarisë bankare e cila tani është ngrirë. Kjo shume është paguar në emër të kryerjes së shërbime "instalimeve elektrike" në objektin afatarist në zonën industriale në Suharek. Për kryerjen e këtyre shërbimeve është lëshuar fatura me datë 07.10.2020 me numër 51-2020 në shumë prej 20.100,00 euro, e cila faturë është bazuar në specifikacionin e punëve për shërbimet e kryera nga punëtorët e M.B.GSHPK. Kjo faturë është regjistruar në Librat e kontabilitetit. Kurse pronari i kompanisë nuk mund të dijë prejardhjen e mjeteve të afataristëve me të cilën punon, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**R.H - R.M av. Ethem Rogova**, pretendon se aktgjykimi përmban shkeljet esenciale nga neni 384 par. 1.12 sepse aktgjykimi nuk është përpiluar me nenin 370 te këtij Kodi sepse ne dispozitiv te aktgjykimit nuk përfshihet vendimi se pala e tretë është shpallur fajtor gjë që është edhe si kusht për zbatimin e dispozitave për konfiskimin e dobisë pasurore. Gjykata ne arsyetimin e aktgjykimit nuk ka paraqit qartë arsyet ne te cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes se çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Gjithashtu nuk i ka vërtetuar faktet vendimtare dhe me rendësi për zgjidhjen e kësaj çështjeje penale. Gjithashtu aktgjykimi nuk përmban arsyet për konfiskimin e secilës pasuri për te cilat urdhërohet konfiskimi.. ashtu si parashihet me par. 9 te nenit 3 70 te KPPRK-së. Si fakt vendimtar ne ketë çështje penale na paraqitet fakti se a mund te konfiskohet pasuria nga pala e tretë nëse i njëjti nuk ka ditur as që ka mundur te dije se mjetet janë fituar nga një aktivitet kriminal. Lidhur me këtë fakt vendimtar gjykata nuk jep arsye vetëm se konstaton se prokuroria e shtetit ka gjurmuar rrjedhën e parasë dhe ne bazë të këtij konstatimi vjen ne përfundim se parat rrjedhin prej një aktiviteti kriminal andaj edhe duhet te konfiskohen dhe pavarësisht asaj nëse këto palë te treta kane qenë ne mirëbesim apo nuk kane pasur mundësi te dinë se ato para rrjedhin nga aktiviteti kriminal duke dhënë një konstatim te përgjithshëm për te gjithë palët e treta e jo veç e veç për secilën pale te trete analizojë rrjedhën e parave. Në rastin konkret kemi te bëjmë me palën e tretë i cili nuk është shpallur fajtor andaj edhe dispozita e nenit 92, 276 dhe 278 te KPPRK-së nuk kane mundur të zbatohen ne asnjë mënyrë sepse pala e tretë jo vetëm se nuk është shpallur fajtor por nuk ka kurrfarë lidhje me veprimet te akuzuarve, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**F.B – F E SHPK av. Blerim Mazreku**, pretendon se PSRK, me datë 03.1 1.2020, ka parashtruar në Gjykatë Themelore në Prishtinë — Departamenti Special, kërkesë për ngrirje të xhirollogarive bankare, ndër të tjera edhe për palët që unë përfaqësoj. Gjykata me datë 04.1 1.2020, ka lëshuar urdhër të përkohshëm ndalues, i cili ka vlejtur 30 ditë. Kjo kërkesë është dashur që ti dorëzohet palëve, me qëllim që brenda afat t ligjor paraqesin kundërshtime e tyre. Gjykata nuk i ka dorëzuar F E SH.P.K dhe Fatmir Bajramit kërkesën e PRSK-së, dhe as urdhrin e përkohshëm ndalues, deri në ditën e mbajtjes së seancave. Për këtë çështje janë mbajtur dy seanca dhe atë në dy ditët e fundit të vlefshmërisë urdhrin të përkohshëm ndalues. Lidhur me bllokimin e xhirollogarive të F E SH.P.K., ne kemi paraqitur pretendimet dhe provat në seancë. Nuk e kemi kontestuar se L-

D-G SH.P.K., nëpërmjet xhirollogarisë së tyre, ka transferuar në xhirollogarisë F E SH.P.K., po ashtu kemi paraqitur pretendimet se ky transfer është kryer për të paguar borxhin për mallrat c ofruar nga F E SH.P.K., për K Shalën si kërkues i këtyre e mallrave, e të cilat ishin shitur pothuajse një vit para se ndodhte rasti, i cili tani është ne hetime sipër, e që vërtetohet edhe me paraqitjen e CD dhe faturës, me të cila prova vërtetohet se pagesa është kryer për punë të vlefshme juridike, e cila është krejtësisht e ligjshme, andaj F E SH.P.K., ne asnjë mënyrë nuk ka ditur dhe as që ka mundur të dijë se paratë e pranuar nga LDA GRUOP SH.P.K. janë përfutuar me vepër penale. Kështu një vendim i tillë është në kundërshtim me nenin 278 të KPP-së, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**G.K SHPK-G.G av. Nazmi Mustafati**, pretendon se në rastin konkret, prokurori i shtetit, edhe pse ka qenë i obliguar t'i sigurojë palës së tretë me emër të subjektit " G.K SHPK" , mbrojtësit një kopje te materialit ose kopje te materialit që i posedon në pajtim me nenin 244 me së voni para ngritjes së aktakuzës, nuk e ka pajisur mbrojtësin e palës së tretë me emër te subjektit G.K SHPK. Shkelje esenciale e dispozitave te procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, përfshirë procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia nuk i kanë zbatuar dispozitat e neneve 244 245 dhe 270 të Kodit Procedurës Penale dhe janë shkelur e drejta për mbrojtje palës së tretë, dhe kjo ndikoi ose mund te ndikonte në marrjen e një gjykimi ligjor dhe të drejtë.

Kështu pala e trete subjekti "G.KOM" nuk ka ditur për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale, ai nuk ka mundur ta dijë për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale, dhe se masa e përkohshme e propozuar palës e tretë Subjektit "G.KOM" ka dëmtuar në mënyrë të paarsyeshme të drejtat e palës së tretë Subjektit "G.KOM", meqenëse pala e tretë subjekti "G.KOM" pasi që ai ka pasur të drejtë pronësore në pasurinë e luajtshme dhe asetin për me shumë se gjashtë muaj para konfiskimit të përkohshëm të pasurisë, pala e tretë, ka pas të lidhur më date 15.01.2020 kontratën me L-D-G" sh.p.k. të cilën e ka përfaqësuar i akuzuari i dytë K.SH, ku lënda e kontratës ka qenë furnizimi dhe montimi i dritareve nga PVC si dhe furnizimi dhe montimi i aluminit projektin e shtëpive në tërë territorin e Republikës së Kosovës, projekt që financohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale, dhe vlera e kontratës ka qenë 400,000.00 euro. Subjekti "G.KOM" ka kryer montimin e dritareve nga PVC si dhe furnizimi dhe montimi i Aluminit për projektin e shtëpive në tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe në emër te borxhit për punët e kryera L-D-G" sh.p.k. te cilën e ka përfaqësuar i akuzuari i dytë K.SH, e ka paguar palën e tretë subjektin afatarist "G.KOM- për punët e porositura dhe te kryera në tërë territorin e Republikës te Kosovës. ku edhe për një pjesë të punëve te kryera pala e trete subjekti afatarist "G.KOM' ka mbetur pa u paguar, e gjithë kjo ka qenë në mënyrë të rregullt, e që vërtetohet në bazë të kontratës, flete dërgesat e materialit, foto dokumentacioni i shtëpive të furnizuara dhe të punuara nga pala e tretë "G.KOM". Gjithashtu në aktgjykimin e atakuar palës së tretë subjektit afatarist G.K i konfiskohet dobia pasurore kinse e fituar me vepër penale, respektivisht Automjeti i tipit Taur ngjyra e bardhë, me numër të shasisë -----, me targa 04---- --Hpt i regjistruar në emër të B.Sh me numër personal 10555. Automjetin të cilin subjekti afatarist "G.KOM' ia ka shitur K Shalës, në kohën para ndodhjes së kësaj çështje juridiko- penale, automjeti i cili fare nuk duhet të jetë objekt kësaj çështje, andaj nga të gjitha të sipërsëhënuarat vlen të potencohet që dobia pasurore e konfiskuar e palës së tretë subjekti afatarist "G.KOM",



nuk rrjedh nga produkti i krimit, dhe se dobia e pasurisë të subjekti afatarist "G.KOM", është fituar në mënyre ligjore, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

**E. SHPK – I.P av. Leutrim Sylja**, pretendon se në rastin konkret, Urdhri Ndalues PPPS.nr.38/20 është marrë me datë 26.10.2020, kurse seanca është caktuar (pas 29 ditësh) me datë 24.11.2020 (shih: faqe 3/7 paragrafi i fundit të Urdhrit Ndalues), që e bën seancën gjegjëse të mbajtur nën Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale. Andaj konsiderojmë se pas kalimit të afatit prej 30 ditësh (sa ishte kohëzgjatja e këtij urdhri), asetet apo xhirrollogaritë e bllokuara është dashur të lirohen pasi që kodi nuk njeh mbrojtje juridike për seanca të mbajtura pas kalimit të afatit prej 3 javësh për konfirmimin e urdhrit ndalues dhe lëshimin e urdhrit ndalues afatatgjatë. Kështu kur kihet parasysh se Urdhri Ndalues Afatatgjatë është dorëzuar të pala e tretë "E. " SHPK me datë 09.02.2021 e që i bie 73 ditë pas lëshimit të tij, është tejet e qartë se ankesa ndaj Urdhrit Ndalues Afatatgjatë është bërë e pamundshme ligjërishit pasi që kishte kaluar afati ligjor për parashtrimin e së njëjtës në Gjykatën e Apelit, dhe me këtë vonesë në dorëzim të Urdhrit Ndalues Afatatgjatë përtej çdo afati logjik dhe të arsyeshëm, palës së tretë i është pamundësuar parashtrimi i ankesës, e kësajsoj edhe i është shkelur drejta e tij kushtetuese. Një vendim i tillë është në kundërshtim me nenin 278 të KPP, ngase nuk kemi të plotësuar asnjërin kusht të paraparë me nenin 278 të KPPK-së e që do të legjitimonte konfiskimin e pasurisë nga pala e tretë "E. " SHPK. Në rastin konkret, pala e tretë "E. " SLIPK i është përgjigjur thirrjes në procedurë paraprake, por nuk është ftuar asnjëherë në shqyrtim gjyqësor kur shqyrtohet konfiskimi i pasurisë për t'u marrë në pyetje, e as që është njoftuar konform ligjit se procedura mund të zhvillohej edhe pa praninë e tij. Së fundmi kemi ekzekutim të një vendimi gjyqësor Gjykatës Themelore në Prishtinë (PS.nr.43/21), të cilin pala e tretë "E. " SHPK nuk e ka pranuar, dhe e drejta në ankesë nuk i është dhënë, andaj nga të sipër cekurat propozon si me lartë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

#### **Të gjeturat lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale**

Gjykata e Apelit pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar në raport me të akuzuarin L.G në raport me pikat I, II, dhe III të dispozitivit të aktgjyimit të ankimuar, edhe pse në këtë pjesë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë vlerësoi sipas detyrës zyrtare, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar për veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 dhe par. 3, pika 4 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së, Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 372/2 lidhur me par 1 të KPRK-së, Vjedhja e identitetit nga neni 336/1 të KPRK-së në raport me këtë të akuzuar nuk është i përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilët kishin me kushtëzuar prishjen e detyrueshme të aktgjyimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, dhe nenin 384, par. 1, nënpar. 1.12 dhe par. 2, nënpar. 2. 1, lidhur me nenin 370 par. 7 të KPPK, tani në fuqi kodi

nr.08/L-032 i procedurës penale, neni 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2 nënpar.2.1 e lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, apo shkelje tjera, të cilat i vëren sipas detyrës zyrtare kjo gjykatë, e të cilët kishin me kushtëzua prishjen e detyrueshme të aktgjykimit. Në dispozitivin e aktgjykimit janë përshkruar në tërësi veprimet inkriminuese e të akuzuarve të cilët formojnë elementet e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor të akuzuari dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike. Në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet për çdo pikë, si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto provat ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë ngase, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPRK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtësit e të akuzuarit K.SH, av.Florent Latifi, se gjykata nuk ka dhënë arsyet për formën e ndihmës dhe atë nëse është e mundur që një person i cili nuk është zyrtarë ti jep ndihmën një zyrtari për kryerjen e një veprë penale që lidhet me detyrën e zyrtar, kjo për faktin se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit, fq.31 dhe 33, ka dhënë arsyet për këtë pretendim duke arsyetuar edhe mos pranimin e tezës së ngritur nga mbrojtja dhe për rrjedhojë ka arsyetuar dijen e të akuzuarit për atë se cilit person është duke i ndihmuar.

Gjykata e Apelit për sa i përket qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me shpalljen fajtor e të akuzuarit K.SH, si ndihmës në kryerjen e veprës penale keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 414 lidhur me nenin 33 par.2 dhe 1 të KPK-së, ndanë të njëjtën pikëpamje me gjykatën e shkallës së parë ngase duke ju referuar përmbajtjes së formulimit të nenit 33 të KPRK-së, rezulton qartë se nuk përjashton asnjë vepër penale apo cilësi e të pandehurit që duhet të ketë për të dhënë ndihmën si formë e bashkëpunimit për të kryer një vepër penale, por ajo në vete ngërthen kërkesën ligjore që kryesi dënohet me dënim më të butë se sa kryesi i veprës penale dhe atë se çka përfshinë për të dhënë ndihmën, dhe që përgjegjësia penale e të akuzuarit për dhënie të ndihmës kryesit për të kryer veprën penale është për shkak të kontributit të tij në dëmtimin e të mirës së mbrojtur, e që në rastin konkretë, si rrjedh edhe nga përshkrimi fakti të dispozitivit II të aktgjykimit të ankimuar, i akuzuari është gjetur fajtor për shkak se të akuzuarit L.G Grudës i ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoriteti zyrtarë nga neni 414 të KPK-së, në atë mënyrë që duke i vënë në dispozicion të dhënat e plota për subjektin “LDA GROU” dhe llogarinë bankare të tij për ti mundësuar këtij të akuzuari që parat nga Buxheti i Republikës së Kosovës t’i transferoj në mënyrë të kundërligjshme në llogarinë e tij, andaj pretendim i mbrojtjes se ndihmë në kryerjen e veprës penale si në këtë rast, mund të ipet vetën nga personi zyrtar e jo dikush tjetër i cili nuk ka këtë cilësi, është e pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitën e lartcekur prandaj për arsyet e cekura si më lartë, duke qenë se në arsyetim të aktgjykimit është arsyetuar dhe vërtetuar se i akuzuari L.G kishte përfituar nga kryerja e veprave penale për të cilat është shpallur fajtur, ku si rezultat i kësaj i është konfiskuar vetuar e regjistruar në emër të bashkëshortes së tij e cila ishte përfituar nga mjetet e kundërligjshme të fituar më këto vepra penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor, andaj dhe pretendimet e mbrojtjes në raport me veprën penale të shpëlarjes së

parasë, se gjykata nuk mundet që aktgjykimin e saj të mbështet në deklaratimet me plot mëdyshje dhe paqartësi, është pretendim i pabazuar ngase gjykata ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor duke dhënë arsyet e qarta lidhur me analizimin dhe vlerësimin e tyre, në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPRK-së, duke përshkruar dhe vërtetuar në mënyrë të sakt vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit.

### **Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes**

Fillimisht, Gjykata e Apelit konstaton se gjendja faktike për veprat penale të përshkruara në pikat I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj gjykate sepse, me ankesë nuk mund të kontestohet gjendja faktike në kuptim të nenit 383 par.2 të KPPRK-së, meqenëse i akuzuari në shqyrtim gjyqësorë të datës 11.02.2022, ka pranuar fajësinë për këto pikat e aktakuzës, kurse trupit gjykues e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari vetëm për pikën I, II, dhe III të aktakuzës prandaj, kjo gjykatë aktgjykimin e ankimuar për veprat penale të cekura si më lartë e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin për këto pikat e dispozitivit të aktgjykimit, për të cilat do të shtjellohet në vijim të arsytimit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësve e të akuzuave, av.Tahir Recaj e Selman Bogiqi, dhe av.Florent Latifaj për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit janë kryes të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuarit K.SH në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimit të ankimuar, ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor nga fakti se me datën më datë 09.10.2020, me dashje dhe me qëllim të krimit të kushteve dhe mundësive për realizimin e veprimeve inkriminuese të pandehurit L.G për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoriteti zyrtarë i ka ndihmuar të njejtin duke i dhënë në dispozicion të dhënat e plota të subjektit juridik “L-D-G” sh.p.k dhe llogarin bankare në TEB Bank, person i autorizuar i të cilës me kompetencë të plotë është i akuzuari K.SH, me të cilin rast i ka mundësuar të akuzuarit L.G që parat nga Buxheti i R.të Kosovës në shumën total prej 2.077.995,90 euro ti transferoj në mënyrë të kundërligjshme në llogarin e këtij subjekti.

Ndërsa, të akuzuarit L.G dhe K.SH, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv III të aktgjykimit të ankimuar kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor për faktin se nga data 09.10.2020 deri më datë 15.10.2020, në Prishtinë, pas marrëveshjes dhe planifikimit paraprakë, në bashkëkryerje, me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës së burimit, vendit, lëvizjes ose pronësisë së parave të transferuara në mënyrë të kundërligjshme, fillimisht i pandehuri L.G, përmes veprimeve inkriminuese duke keqpërdorë detyrën zyrtare dhe autorizimet të përshkruara si në pikën I të dispozitivit, kinse në emër të pagesës për punë të kryera nga kompania “L-D-G” sh.p.k. për

institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht për riparimin e rrugëve, shumën prej 2.077.995,90 euro nga Thesari i R.të Kosovës e ka transferuar në llogarinë bankare në TEB Bankë të subjektit juridik “L-D-G” me pronar Valon Shala dhe person të autorizuar K.SH, si në tabelën e përshkruar në dispozitiv, pastaj i akuzuari K.SH në cilësinë e personit të autorizuar të subjektit juridik “L-D-G” sh.p.k, nga llogaria bankare e këtij subjekti, shumën prej 1.416.413,64 euro, me qëllim të maskimit-fshehjes së burimit të të hollave të fituara në mënyrë të kundërligjshme, i ka vënë në qarkullim ku në emër të blerjes, huazimit, avancit, donacioneve dhe kryerjes së obligimeve (borxhit), i ka transferuar në llogari të ndryshme bankare të personave fizik dhe juridik brenda territorit të R. të Kosovës, të përshkruar si në tabelë të dispozitivit, gjithashtu për qëllime të njejta të theksuara si më lartë, në mënyrë të kundërligjshme, nga xhirollogaria bankare e këtij subjekti juridik, shumën prej 440.000,00 euro i ka transferuar në llogari bankare jashtë territorit të R.të Kosovë, si në tabelën e përshkruar në dispozitiv, dhe për qëllim të njëjtë, përveç veprimeve të përshkruar si më lartë, i akuzuari K.SH nga data 09.10.2020 deri më datë 15.10.2020, ka tërhequr nga banka mjetet monetare në vlerë prej 221.582,26 euro gjëja për pagesa dhe nevoja të kompanisë së tij, të paraqitura si në tabelën në dispozitiv .

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, si ato materiale ashtu edhe ato personale, ku në cilësinë e dëshmitarëve e janë dëgjuar ----- , ndërsa nga provat materiale janë administruara; Raporti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Thesari i Kosovës për periudhën kohore 06.10.2020 deri më datë 20.10.2020, Raporti i ekspertizës nga Drejtoria e Teknikës Kriminalistike nr.141-FVTI i datës 23.12.2020 për ekzaminim e pajisjeve acer-vertion S480G, Raporti i Policisë së Kosovës-Spektori për hetimin e krimeve kibernetike me nr.ref.945/2020 i datës 30.10.2020, i cili përmbanë dëshminë me të dhënat e qasjes, dëshmitë print screen nga SIMFK, të dhënat e përdoruesit të IP adresës dhe listës së pajisjeve kompjuterike në thesar, Raporti i ekspertit financiar me nr.Ref.06/1-02.2021 i datës 08.10.2021 në ndërlidhje me raportin mbi zbulimin e të dhënave financiare nga TEB Bank, e datës 17.11.2020 me referencë TEB 17.11.2020.TB 002, Raporti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Thesari i Kosovës, nr. 243, i datës 15.09.2021, Vërtetimin nga Agjencioni Turistik „Reisburo Dituria” shpk dt 13.10.2020, Lista nga sistemi për menaxhimin e kufirit (SMK) i datës 06.10.2021, Raporti i Ekspertizës nga drejtoria kriminalistike me nr. 141FVTI-2020, dt. 23.12.2020, Raporti i masave të fshehta listingu hyrje dalje me nr. Ref. 2020-KE-123, i datës 21.01.2021, Raporti i Administratës Tatimore të Kosovës-Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, me nr. 449/2021, të dt. 07.10.2021, Raporti i Administratës Tatimore të Kosovës-Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, të dt. 08.10.2021, si dhe Lista e distribuimit nga Dogana e Kosovës-Spektori i Inteligjencës me nr. ref. LJ-I-080—100921, me nr. protokollit 03.1.5/19466/07.10.21, të datës 10.09.2021.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësit av.Tahir Recaj, për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me pretendim se vetëm kontakti përmes telefonit në mes të akuzuarve pa e ditur çfarë kanë biseduar nuk jep të drejtë konkludimi se kanë biseduar për ndonjë marrëveshje të përbashkët për të kryer veprën penale. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet konkrete se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, në mesin e tyre duke u bazuar edhe në komunikimet me telefon që i kanë pasur të akuzuarit ka ardhur në përfundim të vërtetimit të faktit relevant se të

akuzuarit para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale ishin duke komunikuar në mes vete e që në fakt edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate jep për të ardhur në konkluzion dhe përfundim logjik se të akuzuarit, nëpërmjet edhe kësaj prove rrethanore, pra të komunikimit edhe pse jo për nga përmbajtja e bisedave, të vërtetohet se të akuzuarit njiheshin në mes vete para ditës kritike dhe kuptohet duke kontaktuar në mes vete, dhe duke marrë parasysh se nga lidhja kauzale nga veprimi i tyre dhe pasojës së shkaktuar me këtë vepër penale, të jetë vërtetuar fakti se të akuzuarit ishin duke ndërmarrë veprimet si bashkëkryerës në kryerjen e veprës penale të pastrimit të parasë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësit av.Florent Latifaj, për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me pretendim se gjykata ka vërtetuar gabimisht faktet kryesore duke u mbështetur në provat rrethanore, duke konsideruar se gjykata ka paraqitur gjendjen faktike jo të drejtë ngase ka shtrembëruar faktet duke konkluduar se në pamje të jashtme veprimet e të akuzuarit K duken fiktive e që në realitet gjendja faktike është krejt tjetër sepse nga provat e administruara u vërtetua se i akuzuari K.SH nuk i ka ndihmuar asnjëherë të akuzuarit L.G Grudës dhe se dëshmitë e 20 personave-palë të treta e kanë vërtetuar se i akuzuari me transferimin e bërë te këta 20 afatarist nuk ka pastruar parat por ka kryer obligimet që ju ka pasur atyre apo ka paguar mall në avanc.

Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsytet konkrete se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të ketë vërtetuar gjendjen e fakteve andaj pretendimi i mbrojtjes në këtë drejtim për këtë gjykatë është i pabazuar dhe në kundërshtim me provat materiale të cilat vërtetojnë një gjendje tjetër nga ajo që pretendon mbrojtja për atë se çfarë kishte ndërmarrë i akuzuari në raport me mjetet monetare të transferuara nga Buxheti i R.të Kosovës në llogarinë bankare të subjektit juridik në të cilën kishte i vetmi qasjen dhe autorizimin për veprim.

Andaj, kolegji i kësaj gjykate nga arsytet e theksuar më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

### **Të gjeturat lidhur me shkeljet e ligjit penal**

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penale nuk ka shkelje të ligjit penal, kjo për faktin se në gjendjen faktike të provuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit ngase të njëjtit janë penalisht përgjegjës ndërsa në anën tjetër nuk ekziston asnjë nga rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale e të akuzuarve.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor e mbrojtësve të akuzuarit L.G-av.Tahir Recaj, dhe K.SH-av.Florent Latifi, se gjatë marrjes së vendimit është shkelur ligji penal në dëm të pandehurit sepse nga gjendja e vërtetuar faktike nuk del që i pandehurit të ketë ndërmarrë çfarëdo veprimi të drejtpërdrejtë apo tërthortë për kryerjen e veprës penale Shpërlarja e parasë nga neni 302 të KPK-së e në veçanti nuk ka vërtetuar ekzistimin e bashkëkryerjes dhe format e bashkëkryerjes, respektivisht se e tentimi për pastrim duke i transferuar nëpër llogari bankare,

gjykata nuk e din se a janë apo jo fiktive . Kjo ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, fq.35,36,37 dhe 38 ka dhënë arsyet e qarta dhe konkrete për veprimet e ndërmarra inkriminuese duke dhënë arsyet se në cilat provat dhe fakte ka mbështetur për të vërtetuar formën e bashkëpunimit-bashkëkryerjes në këtë çështje penale, për të cilën konkludim pajtohet edhe kjo gjykatë si të drejtë dhe të ligjshëm dhe të provuar nga provat e administruara dhe të vlerësuara drejtë dhe në mënyrë objektive.

### **Të gjeturat lidhur me vendimin mbi konfiskimin e dobisë pasurore nga palët e treta.**

Fillimisht, Gjykata e Apelit konstaton se në raport me propozimet dhe kërkesat e palëve të treta që t'i zhbllokohen xhirollogaritë e tyre bankare, nga shkresat e lëndës vërtetohet se gjykata e shkallës së parë me Urdhrin për zhbllokim të llogarive të datës 10.01.2023, të drejtuar bankave Komerciale të Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës rrjedh se tani të ketë bërë andaj, në këtë drejtim edhe pretendimet ankimore të palëve të treta janë të pabazuara, ngase nga dita e dërgimit të kësaj urdhërese bankave komerciale në fjalë, palëve të treta në këtë rast i është paraqitur mundësia që lirshëm dhe pa ndonjë pengesa nga ky proces penale të kenë mundësi që xhirollogarive të subjekteve të tyre të mund të shfrytëzojnë dhe në këtë drejtim të kryejnë transaksionet për emër dhe llogari të kompanive të tyre andaj, kjo pengesë e disponimit të lirshëm të llogarive të tyre bankare nuk ekziston më si pretendojnë palët e treta në ankesat e tyre.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet ankimore të autorizuarve-avokatëve të tyre dhe vet palëve të treta të parashtruara ndaj aktgjykimit të ankimuar, me pretendimet se aktgjykimi i ankimuar është marrë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në dëm të tyre me rastin e konfiskimit të sendeve dhe mjeteve monetare nga xhirollogaritë e tyre.

Gjykata e Apelit gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore të autorizuarve-avokatëve dhe vet palëve të treta me pretendim se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2 nënpar.2.1 e lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, e të cilat i vërejnë sipas detyrës zyrtare kjo gjykatë, apo shkelje tjera e të cilët kishin me kushtëzua prishjen e detyrueshme të aktgjykimit. Kjo ngase në dispozitivin e aktgjykimit janë përshkuar saktësisht shumat dhe sendet të cilat kanë kaluar në personat e tretë sipas kësaj çështje penale të cilat janë objekt i konfiskimit e të cilat rrjedhin nga veprimet inkriminuese e të akuzuarve për veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm ky dispozitiv, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike në raport me konfiskimin e këtyre mjeteve. Pra, Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto provat ka paraqitur konkludimet e veta në raport me konfiskimin e sendeve dhe mjeteve monetare të përshkuar si në dispozitiv të aktgjykimit, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë ngase nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar padyshim rrjedhja e tyre gjegjësisht transferimit të paligjshëm prej Buxhetit të Kosovës në xhirollogari të subjektit L-D-G sh.p.k gjegjësisht të akuzuarit K.SH e më pas deri te lëvizja e tyre në personat e

tretë, e që më hollësisht janë përshkruar në dispozitiv IV të aktgjykimit, në raport me veprën penale të pastrimit të parës nga neni 308 të KPRK-ës.

Gjykata e Apelit vëren se ankesat e palëve të treta në përmbajtjen e tyre, në thelb, konsistojnë në atë se mjetet monetare të pranuar në llogarit e tyre janë mjetet që janë realizuar në bazë të faturave të lëshuara për blerjen gjegjësisht shitjen e mallit dhe si të tillë nuk janë mjetet të cilat janë fituar nga vepra penale por janë mjetet të cilat kanë ardhur si rezultat i borxheve paraprake gjegjësisht nga shitja e mallit subjekte-palëve të treta sipas kësaj çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka vlerësuar dhe vendosur drejtë kur ka konfiskuar këto mjetet nga personat e tretë në kuptim të nenit 92 të KPK-së dhe nenit 276 dhe 278 të KPP-së pasi që kjo pasuri rrjedh nga vepra penale dhe e njëjta i është kaluar palës së tretë. Pikëpamje të njëjtë si të gjykatës së shkallë së parë e ndan edhe kolegji i kësaj gjykate për faktin se nga provat e administruar rrjedh padyshim se të gjitha këto transaksionet, nëpërmjet faturave të ndryshme, të subjekteve afatariste me përshkrimet si pro faturë, avancë, etj, dhe kalimi në pronësi të veturave të cilat janë objekt i konfiskimit, të rezultojnë të jenë lëshuar dhe fituar menjëherë pas datës së kryerjes së veprës penale nga të akuzuarit dhe kjo tregon një situatë të qartë faktike se aktiviteti i shpëlarjes së parasë nga të akuzuarit nëpërmjet llogarive bankare për te personat e tretë të jenë veprimet të krijuara menjëherë pas kryerjes së veprës penale nga të akuzuarit me qëllim që kjo pasuri- mjete monetare duke i konvertuar në pagesat për blerjen e materialeve të ndryshme ndërtimore dhe të tjera, të paraqitet më vonë si pasuri e ligjshme nëpërmjet sistemit bankar, e jo se ishin detyrimet të mëhershme për punët të kontraktuar nga këto subjekte afatariste gjegjësisht personat e tretë në këtë çështje penale si në rastin e subjektit afatarist “D.K B.I”, subjekti afatarist “U.T ”në raport me “Iso Therm”, e që me të drejtë gjykata e shkallë së parë ka konstatuar se sipas deklarimeve të disa palëve të treta, përveç se kanë i janë lëshuar mjetet monetare në llogarit e tyre, ata asnjëherë nuk kishin dërguar mallin në destinacion për atë blerës, si në rastin e deklaramit të K.RE.

Po ashtu nga shkresat te lëndës vërtetohet kalimi i këtyre të mjeteve-ardhurave nga veprat penale në personat e tretë, ku në raport me veturën në emër të Fitore Maliqi-Gruda, sipas njoftimi të Drejtorisë së Regjistrimit të automjeteve nr.DRA-ARC/2021 të datës 31.03.2021 vërtetohet se është fituar në pronësi më datë.19.10.2020, pra pas datës së kryerjes së veprës penale.

Për veturën në emër të BSH, kontrata mbi shitblerjen e automjetit e noterizuar te Halil Rrukiqi sipas evidencës LPR.nr.7142/2020, Ref.nr.1677/2020, më datë 19.10.2020, ndërmjet L-D-G, sh.p.k –K.SH dhe B.Sh vërtetohet se kalimi i pronësisë është bërë pas kryerjes së veprës penale me qëllim të kalimit nga posedimi i të pandehurit në personin e tretë.

Raporti i DHTI (Drejtoria e hetimit tatimor dhe inteligjencë-ATK, i datës 08.10.2021, për subjektin Klubi futbollistik “Drenasi” OJQ Drenas /60116627398, me të cilin vërtetohet tërheqja e mjeteve nga i pandehuri K.SH pas ditës së kryerjes së veprës penale gjegjësisht transferimit nga Buxheti i Kosovës në llogarinë e bankare të L-D-G, edhe pse nga klubi kishte dhënë dorëheqje 01.07.2019 shuma prej 26.000 euro.

Raporti DHTI (Drejtoria e hetimit tatimor dhe inteligjencë-ATK, i datës 07.10.2021, për subjektin NSH. “Sh R” ShR, me të cilin vërtetohet punë kontraktuale në mes të këtij subjekti dhe N.N.T. “Le” me pronar K.SH, për ndërtim të 8 shtëpive –ndërtim të vrazhdë, investim i MPMS, në vlerë prej 9,100.00 euro (8x9,100.00 euro =72,800.00 euro), ku përmes kontaktit të telefonit i akuzuari K i kërkon xhirollogarinë e këtij subjekti dhe me datë 09.10.2020, i është kryer një pagesë e pjesshme në vlerë prej 45,000 euro, datë në të cilën i është lëshuar edhe fatura në emër të “L”, për punët e kryera në vlerë prej 72,800.00 euro.

Pastaj, nga Dogana e Kosovës, LJ-I-080-100921 datë 10.09.2021, nëpërmjet përgjigjes në kërkesë, rrjedh konstatimi se; Kompania L-D-G sh.p.k nuk është e regjistruar në doganën e Kosovës për import-eksport, por nuk ka importe-eksporte të regjistruara, rrjedh qartazi se këto mjete janë transferuar nëpërmjet llogarisë bankare në Turqi në subjektin Vekoc Makina INS, me qëllim të procesit të shpëlarjes së tyre.

Nga raport i kontrollit nga ATK të datë 09.12.2021, për subjektin “G” sh.p.k, për verifikimi të transaksioneve me subjektin “G-C” sh.p.k, pro faturat me nr.0121001 e datës 13.10.2020 në xhirollogari në ProCreditBank, vlera 50,000 euro, gjegjësisht 3 fatura të lëshuar të gjitha pas datës 09.10.2020, gjegjësisht dt.15.10.2020 vlera 14,990.86 euro, fatura dt. 19.10.2020 vlerë 20,343.93, fatura e datës 20.10.2020 me vlerë 14.664.22 euro.

Raporti i kontrollit të ATK-së, i datës 21.02.2022, për subjektin G-KO sh.p.k në lidhje me transaksionin me LDA ku vërtetohet se G.K ka pranuar në llogarinë tij vlerën prej 300.008.00€ në bazë të pro faktuarës nr. 20-PSV01-001-2, të datës 09.10.20.2020, i cili transferim është kryer në bankë më datë 13.10.2020.

Pastaj blerjet e veturave nga subjekti G.KOM, vlera 55.000.00€, fatura 158/2020 dhe 159/2020, të datës 12.10.2020 tek auto salloni Endriti. Po ashtu subjekti afatarist G.KOM, sipas faturës të datës 13.10.2020, vlera 30.000.00€ ka transferuar subjektit A.M.S në Pro Credit Bank, faturë kjo e cila nuk ka qenë e regjistruar tek librat e blerës tek G.KOM. Vlera prej 20.100.00€ ka të bëjë me faturën e datës 12.10.2020, e lëshuar nga MBG për G.KOM.

Andaj, nga këto provat, si në shkresat e lëndës, vërtetohen të realizuara këto transaksionet nëpërmjet llogarive bankare me mjetet monetare të përfituara me veprat penale nga të akuzuarit e që më pas këto të ardhurat i kanë kaluar personave të tretë nga të akuzuarit.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet e palëve të treta për kthimin e këtyre mjeteve të konfiskuara pasi që për punët të kryera dhe materialet e ndryshme ndërtimore të shituar në bazë të faturave të rregullta subjekteve afatariste si në dispozitiv të aktgjykimit, i kanë realizuar në emër të çmimit të shitblerjes dhe në mënyrë të rregullt por, duke marrë parasysh se në këtë çështje penale këto mjete janë rezultat i fitimit nga vepra penale të kryera nga të akuzuarit dhe të kaluara nëpërmjet xhirollogarive bankare para se të bëhet konfiskimi i tyre, rrjedh se gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka konfiskuar në kuptim të nenit 278 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, ngase nga provat e administruara është vërtetuar padyshim se këto të ardhurat nga vepra penale kanë kaluar



nga posedimi i të akuzuarve në personat e tretë nëpërmjet veprës penale të shpërlajes së parasë, dhe si të tilla për shkak të pjesëmarrjes në këtë proces të shpërlarjes së parasë të kryer nga të akuzuarit këto mjete i nënshtrohen detyrimisht konfiskimit të tyre, ndërsa në anën tjetër në rrethanat e këtilla për palët e treta në asnjë mënyrë nuk paraqet pengës që të realizojnë kërkesat e tyre në procedurë të paraparë ligjore për fitim të pabazë nga palët në obligim.

Andaj, nga të cekura si më lartë kolegji penal ndanë pikëpamjen e njëjtë me gjykatën e shkallës së parë se këto mjete si ato monetare ashtu edhe sendet e luajtshme për shkak se janë të ardhurat e përfituara nga veprat penale të kryera nga të akuzuarit në kuptim të nenit 92 të KP-së duhet të konfiskohen dhe të kthehen në Buxhetin e Kosovës nga i cili edhe janë marrë-derdhur në mënyrë të kundërligjshme në xhirrollogarinë e subjektit L-D-G sh.p.k me të autorizuarin për të njëjtën i akuzuari K.SH.

### **Të gjeturat lidhur me vendimin mbi dënimin**

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit L.G av. Tahir Rrecaj, lidhur me vendimin mbi sanksionin penale sa i përket veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 dhe par. 3, pika 4 në lidhje me paragrafat 1 të KPRK-së, Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 372/2 lidhur me par 1 të KPRK-së, Vjedhja e identitetit nga neni 336/1 të KPRK-së janë të pa bazuara.

Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat, ku si rrethana lehtësuese ka gjetur pranimin e fajësisë nga i akuzuari, dhe keqardhjen e shfaqur nga i njëjti, ndërsa si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe dashjen e të pandehurit në kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 dhe par.3 pika 4 në lidhje me par.1 të KPRK-së, faktin se i njëjti si person zyrtarë ka shkelur rëndë besimin që i është dhënë në bazë të detyrave të punës zyrtare, si dhe kishte shkelur rëndë edhe besimin e kolegëve të tij. Kjo gjykatë i gjen si të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit se gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar rregullat e zbutjes së dënimit, ngase në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është rrethanë veçanërisht lehtësuese, për faktin se me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, andaj edhe ka shqiptuar një dënim më të butë në pajtim me rregullat e zbutjes së dënimit, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kështu që gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese. Kështu që, me vlerësimin e tërësishëm të rrethanave lehtësuese dhe rënduese që ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, dënimi unik i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ndikoj në rehabilitimin e tij dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe me këtë dënim të shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Kurse sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të të pandehurit K.SH av. Florent Latifaj, se shqiptimi i këtij lloji të dënimit ndaj të pandehurit është tejet i rëndë dhe i pa arsyeshëm janë të pa bazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë si rrethanë rënduese e ka marrë faktin se

i njëjti veprat penale i ka kryer me dashje, si dhe faktin se i njëjti ka të kaluar kriminale, kurse e njëjta si rrethanë lehtësuese ndaj të njëjti nuk kishte gjetur, vlerësime të cilat në tërësi i mbështet edhe kolegji penal i kësaj gjykatë, ngase i pandehuri K.SH veprat penale i ka kryer me dashje dhe atë dashje direkte, si dhe faktin se i njëjti ka qenë i dënuar edhe për vepër tjetër penale, e që vërtetohet edhe nga përmbajtja e Aktgjykimit me shenjë PKR.nr. 184/15, të datës 26.05.2016, edhe kjo gjykatë vlerëson se me shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndues, kështu që shqiptimi i një dënimi të tillë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ndikoj në rehabilitimin e tij dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**APS.nr.19/2023, datë: 04.05.2023**

**Bashkëpunëtori Profesional,**

**Anëtarët e kolegjit,**

**Kryetar i kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Bajram Rexhahmetaj**

\_\_\_\_\_  
**Vaton Durguti**

\_\_\_\_\_  
**Burim Ademi**

\_\_\_\_\_  
**Afatërdita Bytyçi**